



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për monitorim të sistemit ligjor

Analiza ligjore e rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë

Tetor 2007

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
PARATHËNIE	4
I. DËSHTIMI PËR TË KUPTUAR ELEMENTET E NEVOJSHME TË	
VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT	5
A. Tri elementet e veprës penale të trafikimit.....	6
B. Trafikimi i fëmijëve	8
C. Çështja e dhënies së pëlqimit nga viktimat	8
D. Trafikimi me njerëz krahasuar me mundësimin e prostitucionit dhe kontrabandimin e imigrantëve.....	9
E. Dështimet e vëzhguara në identifikimin adekuat të elementeve të trafikimit	10
II. DËSHTIMI NË HETIMIN ADEKUAT DHE NDJEKJEN PENALE TË	
TRAFIKIMIT DHE VEPRAVE PENALE TË LIDHURA ME TRAFIKIMIN	11
A. Dështimi për fillimin ose zgjerimin e hetimeve të trafikimit.....	13
B. Dështimi në ndjekjen penale të personave të cilët pranojnë shërbimet seksuale nga viktimat e trafikimit	14
C. Dështimi në ndjekjen penale të trafikantëve për krimet tjera të kryera kundër viktimave të trafikimit	15
III. TRAJTIMI I VIKTIMAVE NË RASTET E TRAFIKIMIT	17
A. Dështimi në identifikimin e viktimave të trafikimit.....	17
B. Dështimi në trajtimin e viktimave si viktimat të trafikimit përveç kur ato bashkëpunojnë	19
C. Ndjekja penale e kundërligjshme e viktimave të trafikimit, për prostitucion ose hyrje ilegale.....	20
D. Dështimi për sigurimin e avokatëve mbrojtës dhe/ose të përfaqësuesve ligjor për viktimat e trafikimit.....	22
E. Dështimi për njoftimin e viktimave të trafikimit lidhur me të drejtat e tyre	24
F. Intervistimi i papërshtatshëm i viktimave të trafikimit.....	25
IV. DËSHTIMI PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE	
NË LËNDËT E TRAFIKIMIT.....	26
A. Korniza ligjore përkitazi me mbrojtjen e dëshmitarëve.....	26
B. Dështimet e vëzhguara në mbrojtjen e viktimave ose dëshmitarëve të trafikimit ..	27
PËRFUNDIMI.....	30
REKOMANDIMET.....	32
ANEKS.....	34

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Problemi i trafikimit të qenieve njerëzore (“trafikimi”) vazhdon të jetë shqetësim i madh për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Monitorimi i rasteve të trafikimit nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) gjatë vitit 2006 dhe 2007 zbulon një mungesë shqetësuese në aspektin e përgatitjes së autoriteteve të Kosovës që të merren me këto raste. Posaçërisht, OSBE-ja ka vërejtur dështim të vazhdueshëm të autoriteteve relevante që t’i vendosin të drejtat e njeriut të personave të trafikuar “në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin, dhe për të mbrojtur, ndihmuar dhe siguruar mundësin e rivendosjes së të drejtave për viktimat.”¹

Në rastet e monitoruara nga OSBE-ja, viktimave nuk u janë siguruar garancitë themelore të parapara me ligj dhe shpesh i janë nënshtruar ndjekjes penale ose kanë qenë të kërcënuara me ndjekje penale. Masat për mbrojtjen e dëshmitarëve janë përdorur shumë rrallë, përkundër kërcënimeve të vazhdueshme që u janë bërë viktimave. Për më tepër, gjyqtarët dhe prokurorët shpesh kanë dështuar të kuptojnë drejtë definicionin ligjor të veprës penale të trafikimit, ose kanë lejuar kryesit e veprës të kalojnë pa u dënuar.

Përgjithësisht, OSBE-ja ka vërejtur që autoritetet e përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të trafikuesve të supozuar, dështojnë të marrin qasje “viktima në qendër” ose të sigurojnë që kryesit e veprës të ballafaqohen me drejtësinë.

Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor i OSBE-së e ka shqyrtuar çështjen e trafikimit edhe në raportet e mëparshme.² Ka gjetur zhvillime pozitive në nivel legjislativ dhe institucional. Sidoqoftë, ende vlejnë shumë nga shqetësimet lidhur me trajtimin gjyqësor të lëndëve të trafikimit.

Prandaj, OSBE-ja mbetet thellësisht e shqetësuar për shkak të dështimit të vazhdueshëm të sistemit gjyqësor të Kosovës që të reagojë në mënyrë adekuate ndaj fenomenit shqetësues të trafikimit me qenie njerëzore.

¹ Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KLKBDNj), Udhëzimet dhe principet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore, Dok. I KB Nr. E/2002/68/Add.1, 20 maj 2002 (“KLKBDNj Principe të rekomanduara”).

² Shqyrtimi i parë i sistemit të drejtësisë penale nga SMSL (korrik 2000), Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë Penale nga SMSL (tetor 2001), Shqyrtimi i katërt i sistemit të drejtësisë penale (shkurt 2002), dhe Shqyrtimi i pestë i sistemit të drejtësisë penale nga SMSL (prill 2003), Shqyrtimi i gjashtë i sistemit të drejtësisë penale nga SMSL (tetor 2004).

PARATHËNIE

Që nga fillimi i vitit 2006, ka pasur 41 lëndë të pakryera të trafikimit në gjykatat e Kosovës.³ Disa lëndë tjera të trafikimit të mundshëm të cilat prokurorët i kanë klasifikuar si krime më të lehta, po ashtu kanë arritur në gjykata gjatë kësaj periudhe. Numri rasteve që s'janë raportuar fare me gjasë është shumë më i madh. Që nga viti 2006 OSBE-ja ka monitoruar⁴ 26 lëndë të trafikimit.

Raporti i tanishëm bazohet në monitorimin e hetimeve dhe gjykimeve të lëndëve të trafikimit në tërë Kosovën dhe përqendrohet në shkeljet e vërejtura të ligjit vendor si dhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁵

Kapitulli i parë jep hollësi mbi mungesën e kuptimit të veprës penale të trafikimit nga gjyqtarët, prokurorët dhe policia. Në radhët e këtyre aktorëve, OSBE-ja ka vërejtur mungesë gjithëpërfshirëse të njohurisë mbi elementet e trafikimit. Si pasojë, lëndët shpesh janë klasifikuar gabimisht si trafikime, ose lëndët që në realitet janë trafikime nuk janë njohur si të tilla.

Kapitulli i dytë analizon dështimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve që të hetojnë si duhet lëndët e supozuara të trafikimit dhe të bëjnë hetimet për veprat lidhur me trafikimin. OSBE-ja ka vërejtur mungesë të qasjes pro-aktive në një pjesë të autoriteteve hetuese për të ndjekur penalisht të dyshuarit për trafikim dhe/ose të krimeve të lidhura me trafikimin (siç janë shfrytëzimi i shërbimeve seksuale dhe dhunimi i viktimave të trafikimit).

Kapitulli i tretë dhe i katërt përqendrohen në rolin e viktimave të trafikimit në procedurën penale kundër kryerësve të supozuar. OSBE-ja ka vërejtur të njëjtin dështim sistematik për të mbrojtur, ndihmuar dëshmitarët dhe viktimat në lëndët e trafikimit, gjë që është vërejtur edhe në lëndët e llojit tjetër.⁶ Dhënia e ndihmës dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit është thelbësore sepse viktimat si të tilla janë veçanërisht të ndjeshme.

³ Bazuar në shifrat zyrtare nga monitorët e OSBE-së në gjykatat e Kosovës. Nga këto 41 lëndë, njëzet e dy janë nga Prishtinë/Prishtina, tetë nga Prizreni, pesë nga Mitrovica, pesë nga Gjiçani/Gnjilane dhe vetëm një nga regjioni i Pejës. OSBE-ja nuk njeht asnjë arsye pse regjioni i Pejës ka më pak trafikim ose lëndë trafikimi. Kjo mund të sugjeroj se autoritetet përgjegjëse në atë regjion kanë dështuar në hetimin adekuat dhe ndjekjen penale të trafikantëve të dyshuar.

⁴ Në përputhje me mandatin e vet, Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor, pjesë e Departamentit për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete në Misionin e OSBE-së në Kosovë bën monitorimin e sistemit ligjor në Kosovë në pajtim me standardet vendore dhe ndërkombëtare, dhe jep rekomandime për zgjidhje të qëndrueshme që të sigurojnë respektimin e këtyre standardeve. Ju lutem shikoni Aneksin ku është dhënë tabela që përmbledh numrin total të rasteve të trafikimit në Kosovë, rasteve të trafikimit të monitoruara nga OSBE-ja dhe numrin total të dënimeve për trafikim në Kosovë.

⁵ Për pyetjet lidhur me aspektet tjera të kësaj çështje (siç janë shkaqet e trafikimit, parandalimi ose rehabilitimi i viktimave) mund t'i referoheni raportit të OSBE-së, Misioni në Kosovë dalë nga Njësia për Antitrafikim brenda Departamentit për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete. *Mekanizmat Referues Kombëtar*, që do të publikohet në tetor 2007.

⁶ Shih Shqyrtimin e Seksionit për Monitorim Ligjor të Sistemit të Drejtësisë Penale, mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, administrimi i drejtësisë në gjykatat për kundërvajtje, të miturit në proceset gjyqësore penale (dhjetor 2006).

Përkrahja adekuatë është po ashtu qenësore për viktimat që të bashkëpunojnë me autoritetet e hetuesisë dhe që të dëshmojnë kundër kryesve të supozuar. Prandaj, kapitulli i tretë merret me mungesën e trajtimit të përshtatshëm të viktimave nga autoritetet relevante, ndërsa kapitulli i katërt fokusohet në dështimin e sigurimit të masave adekuatë mbrojtëse për viktimat dhe dëshmitarët.

Përfundimisht, raporti konstaton se është bërë një përparim shumë i vogël në pesë vitet e kaluara në aspektin e trajtimit të lëndëve të trafikimit si dhe autoriteteve relevant ua adreson një numër rekomandimesh.

I. DËSHIMI PËR TË KUPTUAR ELEMENTET E NEVOJSHME TË VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT

OSBE-ja me shqetësim konstaton se autoritetet gjyqësore (gjyqtarët dhe prokurorët) shpesh dështojnë ta kuptojnë plotësisht veprën penale të trafikimit, ashtu siç parashihet me nenin 139 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).⁷

Neni 139 i KPPK në masë të madhe është inspiruar nga rregullorja e UNMIK-ut 2001/4, Mbi ndalimin e trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë.⁸ Kjo rregullore në vete përmban shumicën e elementeve nga Protokollu i parë plotësues i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Trans-nacional (Konventa e Palermos) e vitit 2000.⁹

Neni 139 KPPK, dënon aktivitetin e secilit “që merret me trafikimin e qenieve njerëzore”, duke bartur mundësinë e dënimit me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet. Ligji po ashtu parashikon dënime më të rënda për organizatorët e grupit të personave që merren me trafikim (shtatë deri në njëzet vjet burgim), ose nëse viktimë është e mitur (tri deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim).¹⁰

KPPK gjithashtu dënon ata të cilët shfrytëzojnë dhe sigurojnë shërbimet seksuale të personit duke qenë në dijeni që ai/ajo është viktimë e trafikimit. Në këto raste, kryesi është objekt i dënimit prej tre muaj deri në pesë vjet,¹¹ për t’u rritur në dy deri në dhjetë vjet nëse viktimë është e mitur.¹² Neni 139 po ashtu dënon lehtësimin e trafikimit nga

⁷ Rregullorja e UNMIK Nr. 2003/25, *mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës*, 6 korrik 2003.

⁸ Rregullorja e UNMIK 2001/4, *mbi ndalimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë*, 12 janar 2001.

⁹ Protokollu për parandalimin, shuarjen dhe ndëshkimin e trafikimit me qenie njerëzore, në veçanti grave dhe fëmijëve, duke plotësuar Konventën kundër krimit të organizuar transnacional, Palermo, 15 nëntor 2000 (“Protokollu i Palermos”).

¹⁰ Neni 139(2), KPPK.

¹¹ Neni 139(5), KPPK.

¹² Neni 139(6), KPPK.

pakujdesia, me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.¹³ Përfundimisht parashikon dënime edhe më të rënda nëse vepra e përmendur më lart kryhet nga personi zyrtar.¹⁴

A. Tri elementet e veprës penale të trafikimit

Neni 139 i KPPK e përkufizon trafikimin me qenie njerëzore se i përmban tri elemente:

1. rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave
2. me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër;
3. me qëllim të shfrytëzimit. Shfrytëzimi është përkufizuar si “shfrytëzim i prostitucionit të të tjerëve ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.”¹⁵

Këto tri elemente të dallueshme mund të shihen si, elementi i “veprimit (aktit)” (rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave”, elementi i “mjetit” (kërcënimi ose përdorimi i forcës apo format tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër) dhe elementi “mental” (qëllimi i shfrytëzimit).¹⁶ Dy elementet e para kërkojnë veçanërisht ekzistimin e *actus reus*, ndërsa elementi i tretë kërkon ekzistimin e *mens rea*. Këto elemente janë shqyrtuar në paragrafët e mëposhtëm.

1) Elementi “i veprimit”

Elementi i parë *actus reus* ose elementi “i veprimit” mund të plotësohet përmes njëres nga pesë veprimet me radhë, respektivisht: (i) rekrutimi; (ii) transportimi; (iii) transferimi; (iv) pranimi; ose (v) strehimi i personit.¹⁷

- (i) “Rekrutimi” nënkupton punësimin e personit; nuk kërkohet që rekrutuesi të ketë për qëllim ta paguajë atë person. Rekrutimi mund të ndodhë jashtë vendit e po ashtu edhe në fshatin ose vendlindjen e viktimës.¹⁸

¹³ Neni 139(4), KPPK. Gjithashtu, neni 140 i KPPK parashikon vepër penale të veçantë “fshehjen e dokumenteve të identifikimit” të viktimave të trafikimit.

¹⁴ Neni 139(7) dhe 140(2), KPPK.

¹⁵ Neni 139(8) 4), KPPK. Ndonëse shumica e lëndëve të supozuara të trafikimit të monitoruara nga OSBE-ja përmbajnë raportime të shfrytëzimit të femrave, trafikimi mund të përfshijë shfrytëzimin e punës (puna e detyruar), shfrytëzimin seksual të meshkujve, heqjen e organeve dhe format e skllavërisë.

¹⁶ Shiko po ashtu nenin 3(a) të Protokollit të Palermos.

¹⁷ Këto kushte nuk janë të përcaktuara në ligjin e Kosovës. Për t’u dhënë udhëzime gjykatave të Kosovës, do të ishte e dobishme që Gjykata Supreme e Kosovës të nxjerr vendime që do të qartësonin definicionet e përshtatshme të këtyre dhe kushteve të tjera të pa përcaktuara në ligjin e Kosovës kundër trafikimit.

- (ii) “Transportimi” nënkupton lëvizjen fizike të personit nga një lokacion në tjetrin. Kjo nuk kërkon domosdo kalimin e kufijve: një person mund të trafikohet edhe përbrenda Kosovës.¹⁹
- (iii) “Transferimi” nënkupton dhënien e kontrollit mbi një person, një personi tjetër, i cili pastaj “e pranon” viktimën e trafikimit (shih më poshtë). Përderisa pagesa me të holla mund të jetë dëshmi që ka ndodhur trafikimi, nuk është element i nevojshëm në veprën penale të trafikimit.
- (iv) “Pranimi” është marrja e kontrollit mbi viktimën (zakonisht nga ndonjë person që më parë e ka “rekrutuar” ose “transferuar” viktimën).²⁰
- (v) “Strehimi nënkupton sigurimin e dhomës ose një hapësire tjetër për personin, por pa e pranuar atë në cilësinë e viktimës (në të kundërtën do të ekzistonte “pranimi”).

2) Elementi i “mjetit”

Elementi i dytë *actus reus* i veprës penale të trafikimit është i ashtuquajti elementi i “mjetit” Ky kusht aplikohet vetëm nëse viktimë e trafikimit është e moshës madhore.²¹ Posaçërisht në nenin 139 të KPPK, kërkohet që kryesi të ketë kryer “veprimet” (rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e personave) në raport me viktimën “me mjete të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme²² ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër.”²³ Prandaj, vetëm transferimi, pranimi, strehimi, rekrutimi ose transportimi i personit nuk përbën në vete veprën penale të trafikimit.

3) Elementi “mental”

Komponenti i fundit i veprës penale të trafikimit është kushti subjektiv, p.sh., shfrytëzimi i qëllimshëm i viktimës. Ashtu si është paraparë qartë sipas nenit 139 të KPPK, shfrytëzimi përfshin por nuk kufizohet në prostitucionin, shërbimet tjera seksuale, punë të detyruar, skllavërim, robërim ose heqje të organeve.

¹⁸ Sipas raportit të Raportuesit special të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e njeriut, *aspekte të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve, Integriteti i të drejtave të njeriut për gratë dhe perspektiva gjinore*, E/CN.4/2006/62, e 20 shkurtit 2006 (“Raporti i Raportuesit Special e vitit 2006”), “trafikimi është trafikim edhe po të ndodhë në fshatin ose qytetin vendlindje të viktimës” (para. 44).

¹⁹ Id.

²⁰ Kjo nënkupton se vetëm vepra e transferimit mund të detyrojë përgjegjësinë e të dy palëve, shitësit dhe pranuesit. Ngjashëm, personi që transporton si dhe personi që pranon, janë që të dy përgjegjës për trafikim.

²¹ Siç është shpjeguar më poshtë, nëse viktimë është fëmijë nuk është e domosdoshme që të jenë përdorur ndonjë nga mjetet e përcaktuara në nenin 139 të KPPK. Elementi “i veprimit” dhe qëllimi i shfrytëzimit mjaftojnë të përmbushin të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit kur viktimë është fëmijë.

²² “Ekziston keqpërdorim i autoritetit ose i një pozite të ndjeshme, e tillë që personi nuk ka zgjidhje reale dhe të pranueshme, por t’i nënshtrohet shpërdorimit ku është përfshirë” (Këshilli i Bashkësisë Evropiane, Vendimi Kornizë Nr. 2002/629/JHA, *Mbi Luftën kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore*, 19 Korrik 2002).

²³ Neni 139(8), Nr. 1, KPPK.

“Qëllimi i shfrytëzimit” është elementi mental *dolus specialis*:²⁴ me fjalë të tjera “veprimi” dhe “mjeti” te kryesi duhet të kenë për qëllim shfrytëzimin e viktimës. Prandaj, nuk është e domosdoshme që kryesi i veprës në të vërtetë ta shfrytëzojë viktimën.

Si rrjedhim, nëse “veprimet” dhe “mjetet” të kryera nga kryesi, (si p.sh. transferimi me përdorim të forcës, pranimi me anë të mashtrimit etj.) janë bërë me qëllim tjetër nga ai i shfrytëzimit të viktimës (p.sh. me qëllim të fitimit të parave nga viktimë), vepra penale e trafikimit nuk është kryer. Sidoqoftë, edhe nëse elementi subjektiv i veprës penale të trafikimit nuk është plotësuar i dyshuari mund të ndiqet penalisht për krime tjera (p.sh. lehtësimin e prostitucionit, kontrabandimi me imigrantë etj.).

B. Trafikimi i fëmijëve

KPPK përcakton prag më të ulët të dëshmive për trafikimin e fëmijëve sesa për trafikimin e personave madhor. Neni 139 i KPPK e bën të qartë se “rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit, duhet të konsiderohet si ‘trafikim i qenieve njerëzore’ edhe nëse kjo nuk përfshin asnjë nga mjetet [...]”.²⁵

Kështu, kur të miturit rekrutohen, transportohen, transferohen, strehohen ose pranohen, nuk është e nevojshme të tregohet që fëmija është mashtruar, kërcënuar etj. Përderisa është logjikisht e pamundur që të ketë lëndë të trafikimit të *madhorëve* sipas përkufizimit nga neni 139 i KPPK në të cilën *nuk* janë përdorur një ose më tepër nga “mjetet”, nuk nevojitet kushti i “mjetit” në rastet kur viktimë e trafikimit është fëmijë.²⁶ Prandaj, vetëm thjeshtë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit, çdoherë i përmbush të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit.

C. Çështja e dhënies së pëlqimit nga viktimë

Në lëndët e trafikimit me të rriturit mund të paraqitet si problem, nëse ka dhënë pëlqimin që t’i nënshtrohet shfrytëzimit – p.sh., prostitucionit ose punës së detyruar. Mirëpo kur, “pëlqimi” i viktimës është dhënë përmes mënyrave të numëruara në elementin e dytë – p.sh., kërcënimit ose përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose përfitimit nga gjendja sociale, fizike ose psikike e viktimës, ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër – atëherë pëlqimi i viktimës nuk është i rëndësishëm e as i vlefshëm.

Ligji i Kosovës e kodifikon këtë interpretim. Sipas nenit 139(8) të KPPK, “pëlqimi i viktimës së trafikimit me qenie njerëzore për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur

²⁴ *Dolus specialis* mund të definohet si qëllim i drejtuar nga kryesi i veprës gjatë kryerjes së veprimit material të veprës penale. Është qëllimi që ka rëndësi, e jo rezultati praktik i realizuar nga kryesi i veprës. Si rrjedhim, arritja e qëllimit nuk është kusht që të përmbushet elementi *dolus specialis*.

²⁵ Neni 139(8) (4), KPPK.

²⁶ Shih nenin 139(8) (3), KPPK.

cilado prej mjeteve të parashtruara më lart në pikën (1) të këtij paragrafi është përdorur kundër viktimës së tillë.”²⁷

KPPK-ja nuk e parasheh fare çështjen e dhënies së pëlqimit dhe (lidhur me) rastet e trafikimit të fëmijëve. Megjithatë, kjo mund të interpretohet si e parëndësishme ngase për trafikimin e fëmijëve nevojitet përmbushja e vetëm dy elementeve, “veprimi” dhe “*mens rea*.” Mjafton të vërtetohet “rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi, ose pranimi” i fëmijës “me qëllim të shfrytëzimit.” Se a e ka dhënë “pëlqimin” fëmija për shfrytëzim apo jo, kjo nuk është e rëndësishme për analizën ligjore për të vërtetuar se a është kryer vepra penale apo jo.

Edhe nëse i pandehuri nuk është fajtor për trafikim, i njëjti mund të jetë fajtor për krime tjera siç janë, lehtësimi i prostitucionit, kontrabandimi me imigrantë ose shkaktimi i lëndimeve të lehta trupore.

D. Trafikimi me njerëz krahasuar me mundësimin e prostitucionit dhe kontrabandimin e imigrantëve

Vepra penale e trafikimit dallon nga vepra më pak serioze e “mundësimit të prostitucionit”²⁸ dhe “kontrabandimi me imigrantë.”²⁹

Sa i përket “mundësimit të prostitucionit”, neni 201(1) i PKKP-së e bënë vepër penale kur me dije rekruton, organizon ose ndihmon një person tjetër apo ia lëshon lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit.” Neni 201(3) i PKKP-së dënon secilin që “me përdorimin e dhunës, me kërcënim se do të përdor dhunën ose duke mbajtur personin tjetër në situatë të varësisë personale a ekonomike e detyron personin tjetër të merret me prostitucion.”

Me nenin 138(7) nr. 1 të PKKP-së, “kontrabandimi me imigrantë” është i definuar si “nxitje (për të arritur [...] deri te përfitimi financiar) nga hyrja ilegale e një personi në Kosovë.” Me të njëjtin nen, është ilegale për secilin që “prodhon [...], prokuron [...], siguron [...] apo posedon [...] dokument [...] të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimit të marrjes me trafikim të imigrantëve.”³⁰ Dispozita e njëjtë gjithashtu e kualifikon si vepër penale asistimin e dikujt për të hyrë dhe për të qëndruar në Kosovë në mënyrë ilegale.³¹

Krimi i trafikimit mund të dalloj nga mundësimi i prostitucionit dhe kontrabandimi i imigrantëve nga fakti që këto dy të fundit nuk kërkojnë qëllimin për të shfrytëzuar viktimën. Për më tepër, vepra penale e mundësimit të prostitucionit nuk nënkupton përdorimin e “veprimeve” të parapara në nenin 139 të KPPK-së. Për veprën penale të kontrabandimit me imigrantë nuk nevojitet përdorimi i cilitdo “mjet.”

²⁷ Neni 139 (8) (4) KPPK.

²⁸ Neni 201, KPPK.

²⁹ Neni 138, KPPK.

³⁰ Neni 138 (1) KPPK.

³¹ Neni 138 (3) KPPK.

E. Dështimet e vëzhguara në identifikimin adekuat të elementeve të trafikimit

Edhe për kundër kërkesave ligjore të parapara me ligj, OSBE ka vëzhguar raste ku prokurorët dhe/ose gjyqtarët i kanë kualifikuar si trafikim situatat ku kanë munguar një apo më tepër nga elementet e kërkuara nga neni 139 i PKKP-së.

Në një rast në Gjiilan/Gnjilane, më 21 prill, 2006 prokurori i qarkut ka ngritur aktakuzë kundër dy personave duke i ngarkuar ata me veprën penale të trafikimit. Megjithatë asgjë në aktakuzë nuk supozonte se dy të akuzuarit kishin qëllim të shfrytëzojnë viktimat e supozuara, nga të cilat thjesht ishin kërkuar para për t'i dërguar në Itali me qëllim të punësimit. Për më tepër, aktakuza nuk sugjeronte që të pandehurit kishin përdorur “mjete” e kërkuara.

Në një tjetër rast të raportuar të trafikimit, me datën 5 prill 2006 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, konfirmoi një aktakuzë duke akuzuar një të pandehur për trafikim. Megjithatë, aktakuza dështoi në paraqitjen e akteve të supozuara që kanë ndodhur, apo që qëllimi i të pandehurit ishte që të shfrytëzojë dy viktimat e supozuara.

OSBE, është e mendimit që gjyqtarët dhe prokurorët duhet t'i analizojnë faktet e rasteve të trafikimit të mundshëm me më shumë kujdes. Prokurorët duhet të përmbahen nga ngritja e aktakuzave për trafikim kundër autorëve të raportuar të krimit kur nuk ka prova se janë përmbushur një apo më shumë prej elementeve.

OSBE ka monitoruar gjithashtu edhe raste kur prokurorët kanë dështuar në identifikimin e rasteve të trafikimit si të tillë.

Në një rast në Prishtinë/Priština, Prokurori i Qarkut pranoi me 21 Mars 2006 nga policia një kallëzim penal në të cilin thuhej se një person e kishte rekrutuar një femër nga Shqipëria duke e mashtruar atë dhe më pas e mbajti atë për 15 ditë në shtëpinë e tij.³² Ai me gjasë e kishte rrahur atë dhe kërkoi nga ajo t'i paguaj atij 3.000 Euro. Nëse ajo do të refuzonte ai do ta shiste atë si prostitutë në Maqedoni. Përkundër prezencës së “veprimeve”, “mjeteve” dhe qëllimit bukur të dukshëm që viktima të shfrytëzohet, prokurori i qarkut ja përcolli shkresat e lëndës prokurorit komunal në Ferizaj/Uroševac për shkak se besonte se rasti nuk përmbante elemente të trafikimit.

Në një rast tjetër në Gjykatën e Qarkut në Prizren, me 8 prill 2003 prokurori i qarkut ka ngritur aktakuzë kundër një të pandehuri për veprën penale të “mundësimit në ushtrimin e prostitucionit.”³³ Gjatë gjykimit prokurori vërtetoi të

³² Vlen të ceket se viktima e pandehur raportoi se një femër Ukrainase gjithashtu jeton në shtëpinë e tij.

³³ Neni 251(1) dhe (2) i Ligjit penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, 28 shtator 1976 në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Nr. 44, 8 tetor 1976.

gjitha elementet e veprës penale të trafikimit.³⁴ Megjithatë, kualifikimi i ultë i veprës penale nga ana e prokurorit e parandaloj gjykatën që ta dënojë të pandehurit për trafikim.³⁵ Megjithatë, me 5 korrik 2007 Gjykata e Qarkut në Prizren e shpalli të pandehurin fajtor për mundësimin e prostitucionit,³⁶ dhe e dënoi atë me gjashtë muaj burgim.³⁷

Në rastin e tretë me 18 nëntor 2004 prokurori i qarkut në Prizren ngriti aktakuzë kundër një të pandehuri për trafikim. Në fjalën e tij përfundimtare prokurori ndryshoi aktakuzën dhe në vend të trafikimit e ndërroj në veprën penale të mundësimit të prostitucionit. Kështu që për deri sa me aktgjykimin e 6 tetorit 2006 e njihte faktin që të gjitha elementet e trafikimit ishin konstatuar, Gjykata e Qarkut e dënoi të pandehurin për një krim më të lehtë, atë të mundësimit të prostitucionit. Gjykata e dënoi të pandehurin me 7 muaj burgim.

Në rastet e lartë-përmendura, kanë ekzistuar prova të qarta se të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit janë përmbushur. Megjithatë, asnjë prej tyre nuk rezultoi me dënim për trafikim.

II. DËSHTIMI NË HETIMIN ADEKUAT DHE NDJEKJEN PENALE TË TRAFIKIMIT DHE VEPRAVE PENALE TË LIDHURA ME TRAFIKIMIN

OSBE është e shqetësuar që autoritetet kanë dështuar në hetimin adekuat dhe ngritjen e kallëzimeve penale kundër individëve të raportuar se janë përfshirë në aktivitetet e trafikimit apo krimeve tjera (p.sh. dhunim) të kryera kundër viktimave të trafikimit.

³⁴ Në fakt, pjesa e arsyetimit në aktgjykim lexon “sepse nga tetori i vitit 2000 deri me 31 Maj 2002 në Prizren i akuzuari (...) ka angazhuar si striptizetë viktimat (...), pastaj i ka detyruar që të merren me prostitucion duke i kërcënuar se do ti raportonte në polici.” Aktgjykimi gjithashtu përmbante faktin që i pandehuri kishte paguar 1500DM për secilën, shumë kjo të cilën ato kanë qenë të obliguara që të kompensojnë kështu që janë pruar në varësi financiare.”

³⁵ Neni 386(2) i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës thotë që gjykata *nuk* do të obligohet nga kualifikimi ligjorë i veprës penale nga ana e prokurorit. Megjithatë, interpretimi i normës në përputhshmëri me të drejtat e njeriut duhet të ndaloj gjyqtarin nga rikualifikimi i veprës në aktgjykim dhe të dënojë të pandehurin për një vepër të ndryshme përmbajtësore nga ajo që është akuzuar në aktakuzë. Kjo do të dëmtonte të drejtën e të pandehurit për tu njoftuar për akuzat kundër tij, dhe kohë adekuate për përgatitjen e mbrojtjes së tij (shih p.sh. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Dallos v. Hungarisë*, 29082/95, aktgjykimi, 1 mars 2001, par. 47), përfundimisht duke rezultuar si gjykim jo korrekt. Neni 6(3) KEDNJ, në fakt i jep të pandehurit të drejtën që të informohet jo vetëm për arsyen e akuzimit, që do të thotë veprat që supozohet që ai i ka kryer dhe në cilën aktakuzë janë të bazuara, por gjithashtu, në detaje karakterizimin ligjor që iu është dhënë atyre veprave (shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Pelissier dhe Sassi v Francës*, 5444/94, aktgjykimi, 25 mars 1992, par. 51). Nëse prokurori gjen që provat e prezantuara në gjykim përkrahin në karakterizim tjetër ligjor të veprës penale, ai ose ajo duhet të ndryshoj aktakuzën gjatë gjykimin, sipas Nenit 376 të KPPPK.

³⁶ Neni 201(3) KPPK.

³⁷ Po që se i pandehuri të ishte ndjekur dhe të ishte shpallur fajtor për trafikim dënimi me siguri se do të ishte shumë më i lartë.

E drejta ndërkombëtare kërkon nga autoritetet e ndjekjes që me përpikëri të hetojnë shkeljet e të drejtave të njeriut,³⁸ përfshirë edhe ato që kryhen nga persona privat.³⁹ Ndalimi i përgjithshëm me ligj i torturës, trajtimit jonjerëzor dhe degradues apo ndëshkimit,⁴⁰ përkundër rëndësisë së tij thelbësore, është joefektiv në praktikë kur mungon një hetim adekuat dhe i cili është i aftë të sjellë deri tek identifikimi dhe dënimi i personave përgjegjës për keqtrajtim.⁴¹ Qeveritë e të cilat i lënë shkeljet private e të drejtave të njeriut të pa adresuara, shkelin detyrimin e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.⁴²

Edhe përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE ka vëzhguar disa rase kur policia apo prokurorët kanë dështuar në hetimin adekuat apo ndjekjen e individëve të përfshirë në trafikim apo aktivitete të lidhura me trafikim. Në mënyrë më specifike, OSBE ka vëzhguar raste kur prokurorët kanë dështuar (a) të zhvillojnë hetime të hollësishme faktike për të vërtetuar ekzistimin e të gjitha elementeve të trafikimit; (b) në ndjekjen e individëve që kanë pranuar shërbime seksuale nga viktimat e trafikimit, apo (c) të paraqesin kallëzime penale të veçanta për veprat penale tjera jo të trafikimit (p.sh. dhunim) të kryera kundër viktimave të trafikimit.

³⁸ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, në komentin e tij të përgjithshëm nr. 3 mbajti qëndrimin se “obligimet pozitive mbi shtetet anëtare për të siguruar të drejtat që burojnë nga pakti konsiderohen që janë realizuar plotësisht nëse individët janë të mbrojtur nga shtetet, jo vetëm kundër shkeljeve të drejtave që burojnë nga pakti nga organet e shtetit, por gjithashtu edhe kundër veprave të kryera nga ana e personave privat.” Për këtë, shtetet duhen “të ndërmarrin masat e duhura dhe të ushtrojnë kujdes të veçantë për të parandaluar, dënuar, hetuar ose të korrigjojnë dëmin e shkaktuar nga akte të tilla nga ana e personave privat. Komenti i përgjithshëm nr. 31 duke zëvendësuar komentin e përgjithshëm nr. 3 sa i përket natyrës së obligimeve të përgjithshme ligjore të imponuara shteteve anëtare të Paktit, 29 mars 2004. Për më tepër KEDNJ dhe PNDKP parashohin të drejtën për mjet ligjor efektiv si konkluzion esencial i kornizës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (shih neni 13 KEDNJ, dhe neni 2(3)(a), PNDKP).

³⁹ Shih Komiteti i drejtave të njeriut i Kombeve të Bashkuara, komenti i përgjithshëm nr. 20 paragrafi 13. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka bërë të qartë sa i përket shkeljeve nga neni 3, ekziston obligimi pozitiv i shteteve që të “sigurojnë secili brenda juridiksionit të vet, të drejtat dhe liritë e përcaktuara me konventë, të marra së bashku me nenin 3, kërkon nga shtetet të ndërmarrin masa të dizajnuara për sigurimin që individët brenda juridiksionit të tyre nuk janë subjekt i torturimit, apo trajtimit jo human dhe degradues, përfshirë këtu edhe keqtrajtimet e tilla të administruara nga persona privat. Këto masa duhet të ofrojnë mbrojtje efektive, në veçanti, për fëmijët dhe persona të rrezikuar, dhe përfshijnë hapa të arsyeshëm për të parandaluar keqtrajtimin të cilin autoritetet kanë pasur ose duhet të kenë njohuri “ (Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Z dhe të tjerët v. UK*, 29392/95, 10 maj 2001, paragrafi 73).

⁴⁰ Kushtet që trafikimi zakonisht detyron (përdorimin e forcës, shfrytëzim seksual, etj.) lehtësisht mund të përbëjnë trajtim johuman apo degradues të ndaluar me Nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁴¹ Shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Assenov dhe të tjerët v. Bullgaria*, 24760/94, 28 shtator 1998, paragrafi 102. Edhe pse dukuria e trajtimit johuman dhe degradues duhet të vlerësohet prej rasti në rast, lehtë mund të argumentohet që shumica e viktimave të trafikimit vuajnë trajtim (siç është prostitucioni i detyrueshëm, dhunimi, rrahjet, izolimi), cila përmban shkelje të Neni 3 të KEDNJ.

⁴² Raporti i Raportuesit Special mbi dhunën kundër gruas, qëllimet dhe pasojat. *Integrimin e drejtave të njeriut të grave dhe perspektivën gjinore dhunën kundër grave*, dok. Nr. E/CN.4/1999/68 shtesa 4, 21 janar 1999 paragrafët 46 dhe 47. Me referencë të veçantë të grave, *Konventës mbi Eliminim e Çdo Lloj Forme të Diskriminimit Kundër Grave* (KEDKG), e 18 dhjetorit 1979, parasheh që të gjitha Shtetet Anëtarë të ndërmarrin masa e duhura për të promovuar të drejtat e gruas përmes shtypjes së trafikimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit (Neni 6).

A. Dështimi për fillimin ose zgjerimin e hetimeve të trafikimit

Sipas udhëzimeve të KB-ve mbi rolin e prokurorëve, prokurorët do ta luajnë rolin aktiv në procedurën penale, duke përfshirë këtu edhe fillimin e ndjekjes.⁴³ Kur ndodhin shkelje serioze të drejtave të njeriut, autoritetet publike duhet të zhvillojnë hetime “që janë në gjendje të çojnë deri tek identifikimi dhe dënimi i personave përgjegjës.”⁴⁴

Duke iu referuar veçanërisht rasteve të trafikimit, Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut deklaruar se “mbi bazën e përgjegjësisë që burojnë nga e drejta ndërkombëtare, autoritetet publike duhet të veprojnë me kujdes të veçantë për ta parandaluar trafikimin, hetuar dhe për t’i ndjekur penalisht trafikantët.”⁴⁵

Megjithatë, OSBE ka vëzhguar disa raste në të cilat prokurorët kanë dështuar në fillimin apo zgjerimin e hetimeve kundër personave të dyshuar për trafikim.

Në një rast të pandehur të trafikimit të hetuar nga prokuroria e qarkut në Prishtinë/Priştina në tetor 2006, Shërbimi Policor i Kosovës kishte dështuar t’i filloj hetimet kundër një personi të njohur i cili ishte i përfshirë në pritjen në aeroport të një numri të viktimave të mundshme nga Moldavia.⁴⁶ Arsyen për mos fillimin e hetimit prokurori e kishte cekur si ky person “nuk ishte më në biznes” me të pandehurin. Në të njëjtin rast, prokurori nuk e kishte hetuar mundësinë e përfshirjes së mundshme të një avokati në aktivitete të trafikimit, në zyrën e të cilit të pandehurit kishin nënshkruar kontrata “pune” me viktimat.

Në një rast të hetuar nga ana e prokurorit të qarkut në Prizren, në deklaratën e saj të dhënë me 12 shkurt 2007, një viktimë e supozuar e trafikimit kishte përmendur një lokal tjetër ku kishte punuar për veç atij të pandehurit – ku disa femra bullgare kishin punuar si prostituta. Një tjetër viktimë e trafikimit kishte përmendur emrin e pronarit të njëjtit lokal në një rast tjetër. Përkundër këtyre dy deklaratave vërtetuese, prokurori kishte dështuar ta hetoj këtë lokal apo pronarin e tij.

Në rastet tjera të monitoruara, prokurorët dështuan që me përkushtim të duhur të hetojnë dhe të mbledhin të gjitha informatat e nevojshme për mbështetjen e rasteve të trafikimit në gjykatë. Rrjedhimisht gjykata nuk ka dënuar të dyshimtit kryesorë në rastet e trafikimit.

Në një rast të hetuar nga prokuroria e qarkut në Prizren lidhur me një trafikim të mundshëm, disa femra moldaviane duke punuar si valltare ose prostituta në një lokal afër Prizrenit, kishin deklaruar se njëri nga të pandehurit i kishte rekrutuar ato në Moldavi. Megjithatë, prokurori nuk kishte hetuar më tutje dhe nuk e kishte

⁴³ Udhërrëfytesa mbi Rrolin e Prokurorëve, i adoptuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kryesve të Veprave, 27 gusht deri me 7 shtator 1990.

⁴⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Assenov v. Bullgaria*, paragrafi 102, dhe *Kaya v. Turqia*, 22729/93, Aktgjykimi, 19 shkurt 1998, paragrafi 107.

⁴⁵ Parimet e Rekomanduara nga UNHCR, Parimi nr. 2.

⁴⁶ Mundësimi nga pakujdesia e veprës penale të trafikimit është gjithashtu i dënueshëm (shih, neni 139(4), KPPK).

përfshirë këtë të dhënë në kuadër të aktakuzës së ngritur më 12 dhjetor 2006. Në këtë mënyrë, edhe për kundër këtyre provave të besueshme të cilat plotësonin të gjitha elementet e trafikimit, kryesit e raportuar të veprës ishin akuzuar për një vepër më pak serioze, me atë të mundësimit të prostitucionit.⁴⁷

Në një rast tjetër të trafikimit të mundshëm, të hetuar nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë/Priştina, në tetor 2006, prokurori dështoi të përcaktoj nëse palët e dëmtuara nga Moldavia (kamerieret dhe viktimat e supozuara të trafikimit) ishin detyruar të kenë marrëdhënie seksuale me klientë. Ai gjithashtu asnjëherë nuk bëri pyetje se pse kishin ardhur ato në Kosovë, për të punuar si kameriere, për të kaluarën e tyre, apo të kërkoj informacione lidhur me raportet e tyre me të pandehurit.

Rastet e përshkruara më lartë tregojnë për mungesë të kujdesit nga ana e prokurorëve për të hetuar ekzistimin e provave që përcaktojnë të gjitha elementet esenciale për të vërtetuar veprën penale të trafikimit. Si rezultat, gjykatat nuk dënojnë të pandehurit për veprën penale të trafikimit. Hetimet me kujdes mund të përfshijnë përgjimin e telefonave të dyshuarve, përgjim me kamerë, sigurimin e dokumenteve financiare – siç janë faturat e pagesave të pagave, apo deklaratat bankare të pandehurve, apo sigurimin e raporteve mjekësore të cilat dëshmojnë keqtrajtimin e viktimave.

B. Dështimi në ndjekjen penale të personave të cilët pranojnë shërbimet seksuale nga viktimat e trafikimit

OSBE është gjithashtu e shqetësuar nga dështimet e përsëritura nga ana e prokurorëve për të hetuar personat të cilët dihet që kanë pranuar shërbimet seksuale nga viktimat e trafikimit.⁴⁸

Individët që pranojnë shërbime seksuale nga personat e trafikuar duhet të ndiqen, pasi që ata krijojnë kërkesën për shfrytëzim seksual të personave të trafikuar. Në fakt, trafikantët e grave dhe fëmijëve për qëllime seksuale nuk do të kishin pasur interes të merren me këso aktivitete sikur mos të kishte persona për të përdorur shërbimet seksuale që i ofrojnë ata/ato. Për më tepër, përdoruesit e shërbimeve seksuale me vetëdije kontribuojnë në shfrytëzimin e viktimave të trafikimit. Për këtë arsye, është e një rëndësie shumë të madhe që prokurorët dhe policia të veprojnë më kujdes të madh në hetimin dhe ndjekjen e tyre.

Megjithatë, edhe pse në shumë raste të trafikimit të vëzhguara nga OSBE viktimat e supozuara i kishin raportuar emrat e personave (p.sh. klientëve, të bareve dhe moteleve) të cilët kanë përdorur shërbimet e tyre seksuale, në shumicën e këtyre rasteve autoritetet kanë dështuar në hetimin apo ndjekjen e kryesve të supozuar.

⁴⁷ Neni 201, KPPK. Shënim, fakti që aktakuza nuk përmbante kallëzim faktik lidhur me rekrutimin e viktimave, ndalojë gjykatësin nga rikualifikimi veprën penale gjatë gjykimit si trafikim.

⁴⁸ Neni 139(5) KPPK e cilëson si vepër penale përdorimin e shërbimeve seksuale nga një person me dijeni që ai ose ajo është viktimë e trafikimit.

Në një rast të hetuar nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë/Priština, tri viktimat të supozuara të trafikimit i kanë paraqitur në polici më 9 shtator 2006, dhe pastaj te prokurori më 16 dhe 17 nëntor 2006 emrat e dy personave të cilët kanë pranuar shërbime seksuale nga to. Policia i kishte marrë në pyetje këta dy persona, të cilët pranuan se kishin paguar për marrëdhënie seksuale me viktimat në një motel. Megjithatë, policia dhe më pastaj prokurori dështuan t'i ndjekin ata.

Në një rast tjetër në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, më datën 27 qershor 2005 dhe 19 korrik 2005 dy viktimat të mitura i kishin dhënë emrat e personave që kishin pranuar shërbime seksuale nga to me kompensim me para. Gjatë seancës gjyqësore më datë 29 korrik 2005, viktimat e supozuara kishin identifikuar fizikisht tre nga këta individë të cilët ishin ftuar si dëshmitarë. Megjithatë, prokurori nuk kishte filluar hetimet apo ngritur aktakuzë kundër tyre. Rasti momentalisht është në pritje të rigjykitimit në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica.

Në rastin në Gjykatën e Qarkut në Prizren, sikur aktgjykimi i gjykatës së qarkut i datës 20 korrik 2005, edhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 28 maj 2007 të cilët dënuan të pandehurit për trafikim vërtetuan se një oficer i SHPK-së kishte kontakte me njërin nga viktimat, një femër nga Moldavia, e cila më herët kishte punuar në një bar pronë e të pandehurve. Oficeri i policisë ishte pajtuar me viktimën sa i përket çmimit për shërbime seksuale. Sipas të dy aktgjykimeve, “nuk ka pasur njohuri personale lidhur me krimet e kryera nga të pandehurit në këtë rast.” Megjithatë, oficeri i policisë është dashur të dijë se femra ka qenë viktimë potenciale e trafikimit dhe është dashur të ndiqet penalisht për pranimin e shërbimeve seksuale nga personi i trafikuar.

Në rastet e përshkruara më lart, autoritetet e hetuesisë injoruan pretendimet dhe provat të cilat kanë mundur dhe është dashur të çojnë deri tek identifikimi dhe ndjekja e kryerësve potencial të krimeve, të parashikuara sipas nenit 139(5) dhe (6) të KPPK.⁴⁹ Dështimi në hetimin dhe ndjekjen e krimeve jo vetëm që shkel standardin e kujdesit të veçantë të kërkuar për ndjekjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut, por gjithashtu kontribuon në përhapjen e problemit të trafikimit pasi që dënimi i kryerësve shërben si frikësues.

C. Dështimi në ndjekjen penale të trafikantëve për krimet tjera të kryera kundër viktimave të trafikimit

OSBE është gjithashtu e shqetësuar sepse në disa raste të monitoruara autoritetet relevante kanë dështuar të ndjekin penalisht personat e dyshuar për përfshirje në trafikim për krime tjera të kryera kundër viktimave. Në veçanti, OSBE ka vëzhguar një tendencë

⁴⁹ Parakusht i nenit 139(5) dhe (6) të KPPK-së është njohuria e përdoruesit mbi statusin e viktimës së trafikimit. Dëshmia e një elementi të tillë mund të përfshijë vështirësi provuese. Mirëpo, standardi i provave është i përmbushur nëse prokurori tregon se një person normal duhet të jetë në dijeni që një grua *mund* të jetë viktimë e trafikimit. Ky “qëllim i mundshëm”, sipas Nenit 15(3) të KPPK-së është i mjaftueshëm. Për këtë, për shembull, një prokuror do të mundte bindshëm të argumentojë që një person që pranon shërbime seksuale nga një femër (e mitur) e huaj në një motel dhe me këtë pranon që ajo mund të jetë viktimë e trafikimit.

shqetësuese të autoriteteve gjyqësore për t'i konsideruar veprimet sikur, sulmi, rrahja dhe dhunimi, kur kryhen në kontekst të shfrytëzimit të viktimës, si pjesë e veprës kryesore të trafikimit dhe jo si vepra të ndara.

Në një rast të raportuar të trafikimit në Gjykatën e Qarkut në Prizren një kolegji i gjyqtarëve ndërkombëtarë kishte vërtetuar në aktgjykimin e datës 20 korrik 2005 se njëri nga trafikantët kishte urdhëruar palën e dëmtuar që ta shoqëroj një oficer të SHPK-së deri në hotel ku oficeri pastaj kishte pasur marrëdhënie seksuale me të kundër vullnetit të saj.⁵⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 28 maj 2007 e kishte konfirmuar këtë gjendje faktike pra se kjo kishte ndodhur. Mirëpo dhunuesi i supozuar kurrë nuk është ndjekur dhe ende punon si oficer i SHPK-së.

Në një tjetër rast të trafikimit të supozuar e të gjykuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Priştina, një viktimë e mitur e trafikimit me 5 dhjetor 2006 deklaroi para prokurorit të qarkut se ishte dhunuar nga ana e trafikueseve të raportuar. Në aktgjykimin e datës 16 prill 2007, trupi gjykues vërtetoi praninë e provave (raportit mjekësorë) që konfirmonin pretendimin e dhunimit. Mirëpo të pandehurit kurrë nuk janë ndjekur për këtë krim.

Në një rast të trafikimit të supozuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë/Peć, një viktimë e supozuar, me 4 gusht 2004 kishte raportuar në prokurori se ishte dhunuar nga trafikuesi i saj. Megjithatë prokurori nuk filloi hetime tjera për veprën penale të dhunimit. I pandehuri përfundimisht u dënua për martesë të detyrueshme me 29 nëntor 2006.⁵¹

Për deri sa trafikimi mund të kryhet me qëllim të shfrytëzimit seksual, dhunimi i viktimës nuk është medoemos element i trafikimit. Për këtë, individ mund të kryej veprën e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit seksual pa e dhunuar viktimën. Për më tepër, përderisa trafikimi është vepër penale kundër lirisë personale,⁵² dhunimi është vepër penale kundër integritetit seksual.⁵³ Prandaj, trafikimi me qenie njerëzore dhe dhunimi janë vepra penale të ndryshme dhe duhet të ndiqen ndaras dhe në mënyrë kumulative.⁵⁴

⁵⁰ Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vepra penale e dhunimit nuk kërkon rezistencë fizike nga ana e viktimës “kërkesa e dëshmitë mbi rezistencën fizike në të gjitha rrethanat rrezikon që disa raste të caktuara të dhunimit të mbeten të pa dënuara dhe kështu rrezikon mbrojtjen efektive të autonomisë seksuale të individit” (Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *M.C. v. Bullgarisë*, 39272/98, Aktgjykimi, 4 dhjetor 2006, par. 165/166).

⁵¹ Neni 207(1), KPPK. Në aktakuzën e 28 shtatorit 2004, prokurori akuzoi të pandehurin për trafikim, Mirëpo, gjatë seancës gjyqësore me 29 nëntor 2006, prokurori ndryshoi aktakuzën dhe akuzoi të pandehurin për veprën penale martesë e detyrueshme. I pandehuri u deklarua fajtor dhe u dënua me 40 dit burgim.

⁵² Për deri sa KPPK-së trafikimin e radhitë në kapitullin e përgjithshëm të “veprave penale kundër ligjit ndërkombëtarë”, kodet tjera (shih Kodin penal të Zvicrës, Neni 186; Kodin penal të Italisë, neni 60 bis) e radhisin këtë vepër nën “krimet kundër lirisë personale.” Kodi Penal i Francës (Neni 225-4-1) përfshinë trafikimin mes “veprave penale kundër dinjitetit të personit.”

⁵³ Neni 193, KPPK-së.

⁵⁴ Si shënim pozitiv, për rastin e parë të shënuar më lartë OSBE e vlerëson vendimin e Gjykatës Supreme për vërtetimin e aktgjykimin të shkallës së parë – të shpallur nga kolegji i gjyqtarëve ndërkombëtarë – për shpalljen fajtor të dy të pandehurve për veprat penale të trafikimit dhe të dhunimit.

Në përmbledhje të gjithë kësaj, prokurorët duhet të hetojnë dhe të ndjekin individët (përfshirë këtu trafikantët) të cilët detyrojnë viktimat e trafikimit në marrëdhënie seksuale pa dëshirën e tyre gjatë trafikimit. Mos ndjekja penale në këtë rast përbën shkelje të standardeve ndërkombëtare të cilat kërkojnë që shkeljet serioze të drejtave të njeriut – siç janë ato të parapara në nenin 3 të KEDNJ (përfshirë dhunimin) – të ndiqen në mënyrë efektive.⁵⁵

III. TRAJTIMI I VIKTIMAVE NË RASTET E TRAFIKIMIT

Të gjitha autoritetet e përfshira në ndjekjen e veprës penale të trafikimit duhet të jenë të përkushtuara, që si çështje prioriteti ta adresojnë dhe sigurojnë mirëqenien e viktimave të trafikimit. Ato, sipas të drejtës ndërkombëtare mbajnë përgjegjësi që të veprojnë me kujdes të veçantë dhe të ndihmojnë dhe mbrojnë personat e trafikuar.⁵⁶ Trajtimi adekuat i viktimave të trafikimit është me rëndësi në mënyrë që të “plotësohen nevojat dhe ruhen interesat e viktimës” dhe “për të ngritur besimin e viktimës në sistemin e drejtësisë dhe për të inkurajuar bashkëpunimin e tyre, në veçanti në cilësi të dëshmitarëve.”⁵⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 në mënyrë të qartë kërkon që oficerët e zbatimit të ligjit të këshillojnë dhe promovojnë të drejtat e viktimave të trafikimit.⁵⁸ Për më tepër, bashkëpunimi i viktimës është vendimtar për qëllime të ndjekjes penale, sepse viktima e trafikimit mund t’u ofrojë autoriteteve të hetuesisë dëshmi kyçe provuese.

Megjithatë, OSBE ka vërejtur dështime të vazhdueshme të policisë, prokurorëve dhe gjykatësve në të kuptuarit e rolit dhe pozitës së viktimave të trafikimit. Nga këtu burojnë disa shqetësime. Së pari, OSBE e ka të njohur se autoritet relevante shpeshherë dështojnë në identifikimin e viktimave të trafikimit, apo u japin statusin e viktimave të trafikimit vetëm nëse ato ofrojnë dëshmi kundër trafikantëve të supozuar. Së dyti, OSBE ka monitoruar raste të ndjekjes penale të kundërligjshme të viktimave të trafikimit për kryerje të prostitucionit ose qëndrim ilegal në Kosovë. Së treti OSBE ka vërejtur një dështim të shkallës së gjerë në informimin e viktimave mbi të drejtat e tyre në procedurë penale dhe caktimin e avokatëve mbrojtës apo përfaqësuesve të autorizuar. Përfundimisht, OSBE ka monitoruar raste të marrjes në pyetje në mënyrë jo adekuate dhe/ose të pandjeshme të viktimave të trafikimit nga ana e autoriteteve gjyqësore.

A. Dështimi në identifikimin e viktimave të trafikimit

Mbrojta e viktimave normalisht fillon me identifikimin dhe njohjen e viktimës.

⁵⁵ “Në pajtim me standardet bashkëkohore dhe zhvillimet në këtë fushë, shtetet anëtare kanë obligime pozitive sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës dhe duhet të duken se kërkojnë inkriminimin dhe ndjekjen penale të çdo akti seksual që bëhet pa dhënien e pëlqimit” (Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *M.C. v. Bullgari*, 39272/98, aktgjykimi i 4 dhjetorit 2003, para. 166).

⁵⁶ Shih Parimet e Rekomanduara nga Komisioneri i Lartë, Parimi nr. 2.

⁵⁷ Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Rekomandimi nr. R(85) 11, *Mbi pozitën e viktimës në kornizën ligjit penal dhe procedurës*, 28 korrik 1985.

⁵⁸ Seksioni 10, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4.

Sipas Konventës së Këshillit të Evropës mbi veprimet kundër trafikimit me qenie njerëzore,⁵⁹ “nëse autoritetet kompetente kanë arsye të bazuar të besojnë se një person ka qenë viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, ai person nuk do të largohet nga territori deri sa të kryhet procesi i identifikimit si viktimë e veprës penale [...] dhe ai person [do të] marr asistencën e paraparë me Konventë.”⁶⁰

Edhe pse nuk është e paraparë në mënyrë të hollësishme me ligjin vendor, obligimi për të përcaktuar dhe identifikuar statusin e personit të trafikuar pa dyshim vjen nga obligimi (që i bie të gjithë aktorëve të përfshirë në procedurë, e veçanërisht policisë dhe prokurorisë) për të mbrojtur viktimat dhe për të parandaluar trafikimin.⁶¹

Pa identifikimin e viktimës, të gjitha të drejtat të cilat i takojnë viktimës bëhen të pavlefshme. Rrjedhimisht, të gjitha autoritetet e përfshira në ndjekjen e rasteve të trafikimit duhet të veprojnë me një vëmendje dhe kujdes të veçantë kur kanë të bëjnë me viktima të mundshme të trafikimit.

Mirëpo, OSBE ka monitoruar raste kur policia ka dështuar në identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit.

Në një rast të trafikimit të supozuar në Pejë/Peć, me 3 korrik 2007, Shërbimi policor i Kosovës kishte arrestuar një grua nga Moldavia e cila punonte si kameriere në një bar, për qëndrim ilegal në Kosovë.⁶² Policia pyeti gruan nëse ishte keqtrajtuar apo nëse e konsideron vetën si viktimë të trafikimit. Pasi që ajo dha përgjigjeje negative, po të njëjtën ditë Shërbimi Policor i Kosovës e dërgoj atë në Gjykatën për Kundërvajtje në Pejë/Peć. Ajo menjëherë është gjykuar dhe dëbuar nga territori i Kosovës.⁶³ Për çudi, në tetor 2006 ajo u morr në pyetje si viktimë e trafikimit në një rast tjetër të hetuar nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë/Priština.

Qartazi, policia nuk kishte pasur kujdesin e shtuar për të përcaktuar nëse kjo grua ishte viktimë e trafikimit. Përfshirja e më hershme në një rast të veçantë të trafikimit të mundshëm duhet të krijojë prezumim e kontestueshëm se një individ është viktimë.⁶⁴ Për këtë arsye, policia nuk do të duhej të kufizojë hetimet e tyre vetëm në marrjen në pyetje të viktimave, dhe nuk duhet patjetër të ndërpriten hetimet nëse viktima mohon se është trafikuar. Kjo paraqet shkelje të obligimit për të hetuar me kujdes të shtuar. Për më tepër,

⁵⁹ Këshilli i Evropës mbi Veprimet Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, 16 maj 2005 (“Konventa e Këshillit të Evropës”).

⁶⁰ Konventa e Këshillit të Evropës, neni 10(2) dhe neni 12.

⁶¹ Shih parimet e përgjithshme të përmbledhura në nenin 2 të Protokollit të Palermos.

⁶² Neni 23(1), Rregullorja e UNMIK-ut 2005/16, *mbi qarkullimin e personave brenda dhe jashtë Kosovës*, 8 prill 2005.

⁶³ Disa elemente në lëndë sugjeronin që gruaja mund të ishte viktimë e trafikimit, përfshirë faktin se edhe pse ishte e punësuar dhe deklaroi që i pëlqente të jetonte në Kosovë, ajo menjëherë kërkoi që të riatdhesohet. Për më tepër, policia dështoi në mbledhjen e informatave të rëndësishme që do të mund të mund ta identifikonin atë si viktimë e trafikimit. Informatat e tilla përshijnë lokalet në të cilat kishte punuar gruaja, punëdhënësit të cilët e kishin rekrutuar, apo për dokumentacionin (lejen e punës, pasaportën) për të cilat ajo pohonte se i posedon.

⁶⁴ Për këtë, krijimi i një data-baze të gjerë në Kosovë të viktimave të trafikimit është e një rëndësie vitale.

policia nuk duhet të bazohet vetëm në mendimin e viktimës për të përcaktuar nëse ajo ose ai duhet trajtuar si viktimë e trafikimit.

Në një rast të hetuar nga zyra e prokurorit ndërkombëtarë në Prishtinë/Priština, në korrik 2006 një viktimë nga Moldavia ishte pyetur nëse e konsideronte veten si viktimë të trafikimit. Ajo u përgjigj negativisht. Rrjedhimisht, ajo privatisht e pyeti përkthyesin për kuptimin e termit “viktimë” dhe domethënien e saj. Kur iu dhanë shembuj të rrethanave dhe keqtrajtimit që do ta bënë atë viktimë, ajo u përgjigj se kishte përjetuar trajtim shumë më të keq.⁶⁵

Në këtë rast viktimë nuk kishte kuptuar konceptin e fjalës viktimë dhe implikimet e saj. Në rastet tjera, individët mund të mohojnë se janë viktimë nga frika e hakmarrjes nga ana e trafikantëve kundër tyre ose familjeve të tyre apo edhe përhapjes së mendimeve negative për të.

Për këtë arsye, policia dhe prokurorët, e veçanërisht ata të kyçur në fazat fillestare të procedurës, duhet të ushtrojnë kujdes të veçantë gjatë përcaktimit të statusit të viktimës së trafikimit. Ata duhet të zhvillojnë hetime shpesh dhe jo të bazohen vetëm në deklaratat e viktimës.

B. Dështimi në trajtimin e viktimave si viktimë të trafikimit përveç kur ato bashkëpunojnë

Pasi që është obligim i autoriteteve publike që të identifikojnë viktimat e mundshme të trafikimit, viktimave duhet t’ju ofrohet mbrojtje dhe kujdes maksimal, pa marrë parasysh nivelin e bashkëpunimit të tyre.

Megjithatë, OSBE ka vërejtur një tendencë shqetësuese të policisë që padrejtësisht të ndalojnë viktimat e mundshme të trafikimit dhe/ose i kërcënojnë ato me kallëzim penal nëse ato nuk ofrojnë prova inkriminuese kundër trafikantëve të supozuar.

Në maj 2006, në Prizren Seksioni i SHPK-së për trafikim me qenie njerëzore (STQNj) intervistoi një gjashtëmbëdhjetë vjeçare nga Shqipëria e cila dyshohej se ishte e trafikuar. Megjithatë, ajo nuk ishte identifikuar si viktimë e supozuar e trafikimit sepse ajo refuzoi t’i jepte policisë informata për trafikantët e saj. Oficeri i STQNj e ndaloi vajzën për 72 orë që t’i jep asaj “pak kohë për të rishqyrtuar deklaratën e saj.” Përfundimisht ajo u akuzua për qëndrim ilegal në Kosovë dhe është riatdhesuar në Shqipëri.

Në një tjetër rast të hetuar nga SHPK në Prizren në tetor 2006, policia mori në pyetje disa gra nga Moldavia për të siguruar prova inkriminuese kundër shfrytëzuesve të mundshëm të tyre. Përkundër dëshmimeve thelbësore (përfshirë hetimet policore) që tregonin se ka gjasa që trafikimi të kishte ndodhur, policia u

⁶⁵ OSBE nuk ka vëzhguar në mënyrë të drejtpërdrejtë marrjen në pyetje. Burimi i informacioneve kërkoi që të mbetet anonim.

tha viktimave se në mungesë të deklaratave që flasin për përfshirjen e tyre si viktimat të trafikimit, ato do të ballafaqohen me akuza për prostitucion.⁶⁶

Ndonëse me qëllimin për të “bindur” viktimat që të dëshmojnë kundër trafikuesve, praktika policore e ndalimit të viktimave të mundshme ose kërcënimi ndaj të njëjtave me ndjekje penale paraqet shkelje të standardeve të të drejtave të njeriut.⁶⁷ Sipas UNHCR, mbrojtja dhe kujdesi që shtetet duhet t’u japin viktimave “nuk duhet të kushtëzohet me kapacitetin apo gatishmërinë e personave të trafikuar për të bashkëpunuar gjatë proceseve gjyqësore.”⁶⁸ Viktimave duhet t’u ofrohet ndihmë dhe mbrojtje, e jo kërcënime për ndjekje penale.⁶⁹ Për më tepër, viktimat mund të hezitojnë të dëshmojnë për arsye se shfrytëzuesit e tyre u kanë bërë presion ose i kanë kërcënuar.

Prandaj, kur dëshmitë tjera sugjerojnë se një person mund të jetë viktimë e trafikimit, pa marrë parasysh deklaratat e viktimës, ai ose ajo duhet të trajtohen si viktimat dhe të gëzojnë mbrojtje ligjore adekuate.

C. Ndjekja penale e kundërligjshme e viktimave të trafikimit, për prostitucion ose hyrje ilegale

Sipas Komisionerit të lartë për të Drejtat e Njeriut, përpjekjet e forcave të rendit nuk duhet “t’i vënë në rrezik për t’u dënuar për veprat penale të kryera si pasojë e situatës së tyre.”⁷⁰ Komisioni mbi eliminimin e diskriminimit ndaj gruas ka nxitur “Shtetet” të “ndryshojnë mentalitetin sipas të cilit i dënojnë viktimat e trafikimit dhe prostitutat”⁷¹ dhe “të ndërmarrin hapa që sigurojnë që viktimat e trafikimit të mos dënohen dhe të gjithë ata që i shfrytëzojnë prostitutat të ndëshkohen dhe ndiqen penalisht.”⁷² Në fund, Konventa Evropiane mbi luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore siguron që shtetet anëtare nuk duhet të imponojnë ndëshkime për viktimat “për përfshirjen e tyre në aktivitetet joligjore, deri në atë masë që ato janë detyruar të veprojnë në atë mënyrë.”⁷³

⁶⁶ Prostitucioni është kundërvajtje kundër qetësisë dhe rendit publik sipas nenit 18(1), pika 6 e Ligjit mbi qetësinë dhe rendin publik (në Gazetën Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovës, nr. 13/1981).

⁶⁷ Policia e arsyeton këtë praktikë me shpjegimin se nëse një grua e cila punon si prostitutë qëndron ilegalisht në Kosovë, nuk është viktimë e trafikimit dhe duhet të akuzohet për prostitucion dhe/ose qëndrim ilegal. Neni 8 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 thotë se viktimat e supozuar duhet të jep dëshmi se ai apo ajo është viktimë e trafikimit që të sigurojë të drejtat ligjore të viktimës së trafikimit. Megjithatë, siç është përkujtuar më lart, duhet të jetë detyrë e autoriteteve hetimore që të identifikojnë viktimat e mundshme të trafikimit, pavarësisht se a e bëjnë atë vet viktimat. Një ndryshim i ligjit do të ishte me shumë rëndësi për ta sqaruar këtë pikë dhe për ta zhvendosur barrën e dëshmisë nga viktimat te policia.

⁶⁸ Shih Principet e Rekomanduara të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, principi nr. 8.

⁶⁹ Këto praktika jo vetëm që e dështojnë kontrollimin e trafikimit, por gjithashtu shkelin nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/4, që siguron se viktimat e trafikimit nuk ka përgjegjësi penale për prostitucion dhe hyrje, punë ose qëndrim ilegal në Kosovë.

⁷⁰ Principet e Rekomanduara të Komisionerit të Lartë, Udhëzimi nr. 5.

⁷¹ Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Publikim shtypi, “Parimi i Barazisë, e Drejta Zakonore, Kushtuar Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe Shqipëria i përgjigjet Komisionit Kundër Diskriminimit të Grave”, 24 Janar 2003.

⁷² Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Komentet përfundimtare të Komisionit mbi Shqipërinë, Dok. nr. A/58/38, 20 Mars, para. 71.

⁷³ Konventa e Konventës Evropiane, neni 26.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/04 mbron viktimat e raportuara të trafikimit nga ndjekja penale. Neni 8 i rregullores thotë që “personi i cili ofron prova që përkrah besim të arsyeshëm që ai ose ajo është viktimë e trafikimit nuk ka përgjegjësi penale ndaj atij personi për prostitucion, hyrje ilegale, qëndrim apo punësim në Kosovë.”⁷⁴

Përkundër kësaj dispozite të qartë, OSBE ka monitoruar rase ku viktimat e mundshme të trafikimit janë ndjekur penalisht për prostitucion ose qëndrim ilegal në Kosovë.

Në një rast të trafikimit të supozuar në Prizren, policia ushtruar kallëzim penal për prostitucion në Gjykatën për Kundërvajtje në Rahovec/Orahovac, kundër dy femrave të cilat më herët ishin marrë në pyetje nga prokurori i qarkut në Prizren si viktima të mundshme të trafikimit. Me 21 nëntor 2006 gjykata “ka ndërprerë procedurën ligjore” kundër dy viktimave për arsye të mungesës së dëshmive, dhe jo për arsye të mungesës përgjegjësisë së mundshme.⁷⁵

Me 27 korrik 2005, pas bastisjes së një hoteli në Prishtinë/Priština, SHPK-ja kishte arrestuar tre persona për trafikim dhe katër femra për prostitucion. Menjëherë pas kësaj, prokurori i qarkut të Prishtinës bëri kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër katër femrave pranë Gjykatës për Kundërvajtje në Ferizaj/Uroševac.⁷⁶ Ato u shpallën fajtores për prostitucion, u dënuan me nga 20 ditë burgim.⁷⁷ Megjithatë, në po të njëjtën ditë, femrat u morrën në pyetje si palë të dëmtuara/dëshmitare në një rast kundër trafikantëve të supozuar, në një hetim të jashtëzakonshëm para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština.⁷⁸ Me 15 gusht 2005 prokurori i qarkut në Prishtinë/Priština, ngriti aktakuzë kundër tre personave për trafikim. Më 23 nëntor 2006, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte shpallur ata fajtor për mundësim të prostitucionit.⁷⁹

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/4, neni 8, policia nuk është dashur të bëjë kallëzim penal për prostitucion kundër viktimave të mundshme të trafikimit. Qartazi me praninë provave për trafikim gjykatat është dashur ta kenë hedhur poshtë rastin.

⁷⁴ Për më tepër, Rregullorja e UNMIK-ut 2005/16, kërkon që viktimat e dyshuara të trafikimit nuk mund të ndiqen penalisht për kundërvajtje lidhur hyrjen dhe qëndrimin në Kosovë e personit të shënuar në Rregullore (shih Neni 23(a) dhe (3), Rregullorja e UNMIK-ut 2005/16) Si shënim, neni 11 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 thotë që dënimi për prostitucion apo hyrje ilegale, qëndrim apo punësim në Kosovë nuk do të jetë bazë për riatdhesim nëse personi është viktimë e trafikimit.

⁷⁵ Nëse do të kishte prova të mjaftueshme, femrat do të ishin gjykuar dhe përfundimisht dënuar. Ajo që është shqetësuese, oficerët e policisë që e udhëhiqnin rastin kërkuar nga OSBE të ndërmarr veprime kundër anulimit “të pa ligjshëm” të rastit.

⁷⁶ Si shënim, femrat (tri shqiptare dhe një bullgare) janë mbajtur në paraburgim gjatë tërë procedurës për kundërvajtje.

⁷⁷ Si shënim, me 5 gusht 1995, Gjykata Supreme për Kundërvajtje e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës për Kundërvajtje.

⁷⁸ Si shënim, me 27 qershor 2007 njëra nga femrat dëshmoi si dëshmitare në një rast të ri të trafikimit të supozuar para Gjykatës Supreme në Prishtinë/Priština

⁷⁹ Edhe pse të tre të pandehurit ishin shpallur fajtor për mundësim të prostitucionit, ekzistimi i një aktakuze për trafikim tregon që ka pas dyshim të bazuar që ato ishin të përfshira në trafikim. Si shënim, me 9 tetor 2006 njëri nga të pandehurit përsëri është arrestuar nën akuzë të trafikimit për një tjetër rast.

D. Dështimi për sigurimin e avokatëve mbrojtës dhe/ose të përfaqësuesve ligjor për viktimat e trafikimit

Ndihma juridike për viktimat e trafikimit është një mjet thelbësor për të siguruar realizimin e të drejtave të tyre. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4 parashikon që viktimave të trafikimit t'u sigurohet këshillim juridik falas.⁸⁰ Për më tepër, KPPPK-ja parashihet që përfaqësuesi i autorizuar⁸¹ t'i ndihmojë viktimat e trafikimit "që nga fillimi i procedurës penale."⁸² Mbrojtësit e viktimave nga Divizioni për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave (DMNV) mund të veprojnë si përfaqësues të autorizuar.⁸³ Policia duhet ta njoftoj DMNV-në çdo herë që marrin në pyetje personin i cili është (dyshohet se është) viktimë e trafikimit.⁸⁴

Shpjegimi i arsyeshëm që qëndron pas kërkesës për ndihmë juridike është se viktimat e trafikimit duhet të pranojnë "ndihmë për të mundësuar që pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre të paraqiten dhe merren parasysh në fazat gjegjëse të procedurave penale kundër kryesve të veprave penale."⁸⁵ Rrjedhimisht, organet e gjyqësisë jo vetëm që duhet caktuar një përfaqësues për viktimën mirëpo ky përfaqësues duhet t'i mbroj të drejtat e viktimës në mënyrë aktive. Për keqardhje, OSBE-ja ka monitoruar dështime në përmbushjen e të dyja këtyre obligimeve.

OSBE-ja ka monitoruar raste kur organet që kanë udhëhequr procedurën kanë dështuar t'u caktojnë përfaqësues të autorizuar viktimave të mundshme të trafikimit.

Në një rast të trafikimit të supozuar, i hetuar nga ana e prokurorit të qarkut në Gjilan/Gnjilane, ku ishin të përfshirë shtatë të pandehur, më 17 maj 2007, pala e dëmtuar dha dëshminë e saj gjatë një seance hetimore. Prokurori nuk i ka siguruar mbrojtësin ose përfaqësuesin e autorizuar për ta ndihmuar viktimën.⁸⁶

Në një rast të hetuar nga prokurori i qarkut në Prishtinë/Priština, dy të pandehur të dyshuar për trafikim kanë dhënë dëshmitë e tyre në prokurori më 15 mars 2007. Në këtë rast nuk ishte i pranishëm as ndonjë mbrojtës e as përfaqësues i autorizuar i palës së dëmtuar.⁸⁷

⁸⁰ Neni 10(1)(b), Rreg. e UNMIK-ut nr. 2001/4.

⁸¹ Në bazë të nenit 151(7) të KPPPK-së "[t]ermi 'përfaqësues i autorizuar' nënkupton personin i cili [...] vepron në emër dhe për të mbrojtur interesin e palës së dëmtuar."

⁸² Neni 82(1), pika 3, KPPPK.

⁸³ Neni 81(4), KPPPK.

⁸⁴ Shih nenin 206(1) dhe nenin 82, KPPPK.

⁸⁵ Shih nenin 6(2)(b), të Protokollit të Palermos.

⁸⁶ Neni 82(2) i KPPPK-së parashihet që "në rastet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, në rast se pala e dëmtuar ose përfaqësuesi i saj/tij ligjor nuk angazhon një përfaqësues të autorizuar, kryetari i gjykatës ose autoriteti përgjegjës që udhëheq procedurën paraprake do të caktoj një përfaqësues të autorizuar sipas detyrës zyrtare në shpenzime publike."

⁸⁷ Në bazë të nenit 81(4) të KPPPK-së, mbrojtësit e viktimave do të ndihmojnë palën e dëmtuar në mbrojtjen e të drejtave të tyre, përfshirë këtu, në rastet kur është e përshtatshme, të veprojnë edhe si përfaqësues të autorizuar.

Në një rast të një të pandehuri të akuzuar për trafikim pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, shqyrtimi kryesor i datës 29 nëntor 2006 u mbajt në mungesë të palës së dëmtuar. Veç kësaj, viktimë nuk ishte e përfaqësuar as nga ndonjë mbrojtës apo përfaqësues të autorizuar. Në fillim ishte e pranishme mbrojtësja e caktuar nga ana e gjykatës sipas detyrës zyrtare, por pas një kohe të shkurtër u largua nga salla e gjykimit pasi që kuptoi se “viktimë nuk kishte qenë e mitur në kohën kur ishin kryer veprat e supozuara.”

Në rastet e përshkruara më lartë, gjyqtarët dhe prokurorët kanë dështuar të caktojnë mbrojtës ose përfaqësuesin e autorizuar sipas detyrës zyrtare për t’i ndihmuar viktimat.⁸⁸ Kjo jo vetëm që paraqet shkelje të ligjit por, gjithashtu i ekspozon viktimat e trafikimit ndaj dëmtimit psikologjik dhe trajtimit e intervistimit të papërshtatshëm.⁸⁹

Një shqetësim tjetër i OSBE-së është se në pjesën dërrmuese të rasteve të monitoruara, përfaqësuesi i DMNV-së, edhe atëherë kur ka qenë i pranishëm, nuk e ka asistuar viktimën në mënyrë aktive.⁹⁰

Në një rast të trafikimit të supozuar, pranë autoriteteve në Gjilan/Gnjilane, mbrojtësja e viktimës e ka asistuar viktimën gjatë tërë procedurës në cilësi të përfaqësuesit të autorizuar. Mirëpo, ajo nuk ka propozuar asnjë dëshmitarë dhe as nuk e ka marrë në pyetje ndonjërin nga dëshmitarët e dëgjuar. Në shqyrtimin kryesor të datës 26 shtator 2007 kryetari i trupit gjykues nuk kërkoi të dëgjoj fjalën përfundimtare të palës së dëmtuar, mirëpo as mbrojtësja e viktimës nuk e bëri një gjë të tillë. Rrjedhimisht, palës së dëmtuar nuk iu ofrua mundësia për t’i “përmbledhur argumentet e veta” siç parashihet me nenin 378 të KPPPK-së.

Në një rast tjetër të trafikimit të supozuar pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priştina, gjatë seancës më 29 qershor 2007, mbrojtësja e viktimës është caktuar si përfaqësuese e autorizuar e viktimës. Megjithatë, ajo nuk i ka ndihmuar viktimës në mënyrë aktive, dhe gjatë procedurës gjyqësore nuk ndërmori asnjë veprim.

Mbrojtësit e viktimave gëzojnë pozitën më të mirë për t’u ofruar viktimave të trafikimit ndihmë efektive ngase ato mbajnë kontakt të afërt me to, si dhe i kuptojnë nevojat e tyre. Fatkeqësisht, qëndrimi shpeshherë pasiv i mbrojtësve të viktimave i lë viktimat në mungesë të ndihmës efektive.

⁸⁸ Shih nenin 82(2), KPPPK.

⁸⁹ Shih nën paragrafin F.

⁹⁰ Mbrojtësit e viktimave kur veprojnë si përfaqësues të autorizuar, mund të ushtrojnë të gjitha të drejtat që ligji u a ofron palëve të dëmtuara (d.m.th. të parashtrajnë padi pronësore, të propozojnë dëshmi, t’u bëjnë pyetje dëshmitarëve dhe të pandehurve, të komentojnë dhe të parashtrajnë vërejtje). Shih Nenin 80 dhe 81, KPPP.

E. Dështimi për njoftimin e viktimave të trafikimit lidhur me të drejtat e tyre

Që viktimat t'i gëzojnë të drejtat e tyre,⁹¹ ato duhet të dijnë për to.⁹² Në rastet e trafikimit, shpeshherë niveli i ulët i arsimimit i shumë viktimave e bën edhe më të rëndësishme që autoritetet në mënyrë aktive t'ua shpjegojnë viktimave të drejtat e tyre.⁹³

Protokolli i Konventës së KB-ve në Palermo⁹⁴ përcakton që “viktimat e trafikimit njerëzor [do të] informohen mbi procedurat relevante si gjyqësore ashtu edhe administrative si dhe për ndihmën.”⁹⁵ Andaj, neni 10(3) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 parasheh që zyrtarët e zbatimit të ligjit në mundësinë e parë që u ofrohet, t'i këshillojnë personat që dyshohen të jenë viktimat të trafikimit për të drejtën e tyre për të kërkuar shërbimet dhe mjetet dhe të kontaktojnë personat gjegjëse me qëllim të sigurimit të ndihmës së kërkuar.⁹⁶ Veç kësaj, KPPPK-ja i obligon të gjitha organet që udhëheqin procedurën penale të informojnë palët e dëmtuara për të drejtat e tyre në kuadër të procedurës penale.⁹⁷

Përkundër këtyre masave të qarta, OSBE-ja ka vërejtur raste kur viktimat e supozuara të trafikimit janë njoftuar në mënyrë jo të plotë për të drejtat e tyre ligjore ose edhe nuk janë informuar fare për këto të fundit.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština kundër pesë të pandehurve të dyshuar për trafikim, katër viktimat të supozuara janë dëgjuar në kuadër të mundësisë së jashtëzakonshme hetimore të mbajtur më 16 tetor 2006.⁹⁸ Asnjë mbrojtës i viktimës nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës. As prokurori nuk i ka informuar viktimat për të drejtën e tyre për t'u ndihmuar nga përfaqësuesi i autorizuar. Veç kësaj, viktimat nuk janë informuar për mundësinë për të parashtruar

⁹¹ Krahës të drejtave të parapara me KPPPK-në për çdo viktimitë (neni 80, KPPPK), seksioni 10(1) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 siguron një grup të drejtash për viktimat e trafikimit, sikurse janë “(a) shërbimet falas të përkthimit në gjuhën e zgjedhur nga vet viktimat; (b) këshilltar ligjor falas në lidhje me çështjet e trafikimit (qoftë penale ose civile); dhe (c) strehim të sigurt të përkohshëm, ndihmë psikologjike, mjekësore dhe të mirëqenies sociale që mund të jenë të nevojshme për t'i plotësuar nevojat e tyre.”

⁹² Ndërsa disa të drejta (sikurse është ndihma falas e një këshilltari ligjor, ose përkthimi) duhet thjeshtë të sigurohen nga sistemi gjyqësor, viktimat duhen të mësohen për të drejtat tjera (sikurse është e drejta për të propozuar dëshmi, për t'i parashtruar pyetje të pandehurve, ose për të parashtruar kërkesë pronëso- juridike) në mënyrë që ai/ajo të mund t'i ushtroj ato.

⁹³ Siç përshkruhet më lartë, disa viktimat madje as nuk e kuptojnë domethënien e termit “viktimë.”

⁹⁴ Neni 6, pika 2, Protokolli i Palermos.

⁹⁵ Për më tepër, Deklarata e parimeve themelore të të drejtave të viktimës parasheh që “viktimat duhet informuar për shërbimet mjekësore dhe sociale në dispozicion si dhe për format e tjera relevante të ndihmës dhe në mënyrë të lehtë t'u sigurohet qasja në ato shërbime” (*Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit e miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 40/34 të datës 29 nëntor 1985, par. 15*).

⁹⁶ Neni 10(3), i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4.

⁹⁷ Shih nenin 80(5), KPPPK.

⁹⁸ Shih nenin 238 ff., KPPPK.

kërkesë pronëso-ro-juridike,⁹⁹ si dhe për të drejtat tjera që u takojnë si palë të dëmtuara.¹⁰⁰

Në një rast tjetër pranë Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, më 19 janar 2007, prokurori mori në pyetje një palë të dëmtuar. Jo vetëm që prokurori dështoi që viktimës të ia caktoj një përfaqësues të autorizuar, mirëpo gjithashtu nuk e udhëzoi viktimën për të drejtat të cilat i takojnë asaj sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4.

Në shembujt e përshkruar më lartë, viktimat nuk janë informuar në mënyrë të duhur për të drejtat e tyre si palë të dëmtuara, dhe kështu është bërë shkelje e ligjit në fuqi. Kjo, krahas mungesës së shpeshtë të ndihmës efektive nga ana e përfaqësuesit të viktimës e bën gati të pamundshme për viktimat e trafikimit të ushtrojnë të drejtat e tyre në procedurë penale ku janë të përfshirë trafikantët e supozuar.

F. Intervistimi i papërshtatshëm i viktimave të trafikimit

Sipas Deklaratës mbi parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit, “viktimat duhet trajtuar me dhembshuri dhe respekt për dinjitetin e tyre.”¹⁰¹ Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës rekomandon që “në të gjitha fazat e procedurës viktimat duhet të merret në pyetje në mënyrë që situatës së saj personale, të drejtave dhe dinjitetit të saj t’i kushtohet konsideratë e duhur.”¹⁰²

Megjithatë, OSBE-ja është e brengosur ngase në disa nga rastet e monitoruara autoritetet gjyqësore kanë shprehur qëndrime të pandjeshme dhe të papërshtatshme ndaj viktimave të supozuara të trafikimit.

Gjatë një shqyrtimi kryesor të mbajtur më 6 mars 2007 për një lëndë të trafikimit pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, avokatit mbrojtës i është lejuar ta pyes palën e dëmtuar rreth problemeve të saj të mëhershme me marihuanë. Pala e dëmtuar refuzoi t’i përgjigjet kësaj pyetjeje.

Në një rast të trafikimit të supozuar të hetuar nga prokurori i qarkut në Prizren, më 2 shkurt 2007, prokurori e mori në pyetje viktimën e supozuar, femër kjo nga Shqipëria. Pyetjet e parashtruara ia bëri në formë akuzuese dhe të pandjeshme ndaj traumave që ajo mund t’i kishte përjetuar asokohe. Për shkak të sjelljes së prokurorit viktimat mori qëndrim mbrojtës dhe nuk bashkëpunonte.

⁹⁹ Neni 165(7), KPPPK. Pala e dëmtuar mund të parashtoj kërkesë pasurore-juridike për të kompensuar dëmin si pasojë e veprës penale (shih nenin 107 ff. të KPPPK-së).

¹⁰⁰ Neni 80, KPPPK.

¹⁰¹ Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit, par. 4.

¹⁰² Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Rekomandimi nr. R (85) 11 për shtetet anëtare, mbi pozitën e viktimës në kuadër të ligjit penal dhe procedurës, më 28 qershor 1985.

Teknikat e intervistimit të papërshtatshëm dhe mungesa e ndjeshmërisë në anën e policisë, të prokurorëve dhe gjyqtarëve përballë viktimave të trafikimit¹⁰³ shpeshherë i dekurajojnë viktimat nga bashkëpunimi dhe dhënia e deklaratave të qarta, të hollësishme dhe të sinqerta. Përkundrazi, viktimat i frikohen ndjekjes penale dhe ngurrojnë të bashkëpunojnë me organet e gjyqësisë. Sjellja e këtillë njëkohësisht cenon të drejtat e viktimave për t'u trajtuar me respekt të plotë për dinjitetin e tyre.

IV. DËSHIMI PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE NË LËNDËT E TRAFIKIMIT

A. Korniza ligjore përkitazi me mbrojtjen e dëshmitarëve

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat të Njeriut, jeta, liria dhe siguria e dëshmitarëve nuk duhet “vënë në rrezik në mënyrë që nuk arsyetohet.”¹⁰⁴ Andaj, autoritetet publike kanë për detyrë t'i mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmit e tyre të ngushtë ndaj ndërhyrjeve, kërcënimeve dhe rrezikut, para, gjatë dhe pas gjykimit.¹⁰⁵ Mbrojtja efektive e dëshmitarëve është vendimtare që një sistem ligjor të funksionoj siç duhet.¹⁰⁶

Kjo ka rëndësi të veçantë në rastet e trafikimit, ku të pandehurit mund të jenë pjesëtarë të krimit të organizuar dhe viktima mundet që në të njëjtën kohë të jetë dhe dëshmitare kyçe që e bën atë të ndjeshme ndaj kërcënimeve dhe frikësimit. Në mungesë të mbrojtjes adekuate të viktimës dhe të dëshmitarëve, prokurorët nuk do të mbledhin të gjitha provat e nevojshme që çojnë drejt dënimit të trafikantëve ndërsa viktimat dhe dëshmitarët mund të dëmtohen edhe më tutje. Neni 6(d) i Protokollit të Palermos thotë që “autoritetet publike duhet të bëj përpjekje për të siguruar sigurinë fizike të viktimave të trafikimit me njerëz përderisa ato të gjinden përbrenda territorit të vet.”

Për të inkurajuar dëshminë e dëshmitarit dhe për të mbështetur ndjekjen e suksesshme penale Kosova ka nxjerrë tashmë norma juridike që kanë për qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve.

¹⁰³ Vini re që në të dyja rastet e përshkruara mbrojtësit e viktimave, që ishin të pranishëm, nuk ndërmorën asnjë hap për të ndaluar pyetjet e papërshtatshme.

¹⁰⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Van Mechelen e të tjerë v. Holanda*, 21363/93, 21364/93, 21427/93, e datës 23 prill 1997, par. 53. Gjithashtu shih *Doorson v. Holanda*, 20524/92, e datës 26 mars 1996, par. 70 dhe *P.S. v. Gjermania*, 33900/96, e datës 20 dhjetor 2001, par. 22.

¹⁰⁵ “Duke respektuar të drejtat e mbrojtjes, mbrojtja e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe personave të afërt me ta duhet organizuar, kudo që është e nevojshme, para, gjatë dhe pas gjykimit.” Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, Rekomandimi (2005)9 mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, e datës 20 prill 2005, neni II(2). Për një pasqyrë të çështjeve të përgjithshme në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, ju lusim të shihni grupin punues mbi mbrojtjen e dëshmitarëve brenda sistemit gjyqësor, pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogë dhe krim, Vjenë 22 – 24 shtator 2005.

¹⁰⁶ “[...] Është e papranueshme që sistemi i drejtësisë penale të dështoj të sjellë të pandehurit në gjykim dhe të merr aktgjykim ngase dëshmitarët kanë qenë aktivisht të dekurajuar për të dëshmuar në mënyrë të lirë dhe të vërtetë.” Id., Parathënie.

KPPPK-ja¹⁰⁷ e lejon fshehjen e identitetit të dëshmitarëve, shqyrtimet jopublike, largimin e përkohshëm të të pandehurit nga salla e gjykimit gjatë kohës kur dëshmitari jep dëshminë e vet, dëshmia e dhënë nga distanca (p.sh. nëpërmes të video-konferencës ose qarkut të mbyllur televiziv), ose video-incizimi i ekzaminimit i realizuar para seancës gjyqësore në praninë e avokatit mbrojtës.¹⁰⁸

Veç kësaj, Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve parasheh mbrojtjen fizike të dëshmitarëve para, gjatë dhe pas gjykimit nga ana e njësisë së specializuar të policisë, të njohur me emrin Njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve e UNMIK-ut (NjMD). Qarkorja e drejtësisë nr. 2003/5 *mbi programin për mbrojtjen e dëshmitarëve* në pika të shkurtra përshkruan procedurat për t'u kyçur në Programin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Synim i këtij programi është të mbrojë dëshmitarët në rastet më të rënda penale sikurse janë rastet e krimit të organizuar, trafikimit me njerëz dhe rastet e krimeve të luftës.¹⁰⁹ Fatkeqësisht, për momentin, Kosova nuk ka ndonjë ligj të hollësishëm ose procedurë për përfshirjen e dëshmitarëve në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, ndërrimin e identitetit të tyre dhe zhvendosjen e tyre jashtë Kosovës pas gjykimit. Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve bazohet në një Qarkore të drejtësisë të shkurtër që nuk është e mjaftueshme. Drafti i një Rregulloreje për mbrojtjen e dëshmitarëve është qarkulluar në kërkim të komenteve dhe miratimit si dhe zbatimit të saj duhet dhënë prioriteti më i lartë i mundshëm.

B. Dështimet e vëzhguara në mbrojtjen e viktimave ose dëshmitarëve të trafikimit

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE-ja ka vëzhguar raste kur prokurorët dhe gjyqtarët vazhdojnë të mos i përfillin masat qëllimi i të cilave është të mbrojnë viktimat e trafikimit dhe dëshmitarët dhe që të ndihmojnë ndjekjen e suksesshme penale të trafikantëve. Masat mbrojtëse siç janë, zhvendosja e dëshmitarëve, përdorimi i pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, apo ndarja fizike e të pandehurit nga viktimat dhe dëshmitarët nuk është zbatuar në asnjë nga rastet e monitoruara nga OSBE-ja. Përdorimi i një pseudonimi për një viktimë/dëshmitar ka ndodhur vetëm në një rast të monitoruar nga OSBE-ja.

Në pjesën më të madhe të rasteve të monitoruara të trafikimit OSBE-ja ka vërejtur ose incidente të frikësimit ose të kërcënimit direkt ndaj viktimave/dëshmitarëve ose dëshmi

¹⁰⁷ Mirëpo, përdorimi i dëshmisë anonime (në veçanti pa zhvendosje) mund të jetë problematik. Së pari, i pandehuri mund të hamend identitetin e vërtetë e dëshmitarit anonim bazuar në natyrën dhe veçantitë e dëshmisë. Veç kësaj, siç përshkruhet më lartë, dënimi i cili bazohet “vetëm” ose “deri në një masë vendimtare” në dëshmi anonime mund të shkaktoj shqetësime përkitazi me pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për një gjykim të drejtë (shih nenin 157(3) të KPPPK-së).

¹⁰⁸ Nenet 168-174, KPPPK. Para se të hynte në fuqi KPPPK-ja, me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/20 *Mbi Mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve në procedura penale* të datës 20 shtator 2001 dhe Udhëzimi Administrativ me nr. 2002/25 të datës 13 nëntor 2002 parashiheshin masat për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve gjatë dhënies së dëshmisë.

¹⁰⁹ Masat për mbrojtjen e dëshmitarëve në kuadër të KPPPK-së (sikurse është ndarja e të pandehurit nga dëshmitari, dëshmia e dhënë nga distanca dhe shqyrtimet jopublike) duhet zbatuar në pjesën më të madhe të rasteve ku dëshmitarët mund të jenë të kërcënuar ndërsa nuk janë të përfshirë në Programin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

(sikurse rastet kur viktimat/dëshmitarët ndryshonin deklaratat e tyre) që kërcënim i dëshmitarit ose i viktimës mund të ketë ndodhur.¹¹⁰

Në një rast të trafikimit të supozuar në Pejë/Peć, më 5 prill 2006 një grua deklaroi para policisë se një mashkull e kishte dërguar atë në banesën e tij dhe atëherë kishte tentuar t'ia shes atë personave të tjerë.¹¹¹ Për më tepër ai supozohet të ketë detyruar atë që të ketë marrëdhënie seksuale me klientë të ndryshëm. Më 3 maj 2006, ajo rrënjësisht e ndryshoi deklaratën e saj fillestare të cilën e kishte dhënë pranë prokurorit të qarkut. Veç kësaj, ajo deklaroi se “i frikohej shumë” të pandehurit.

Në një rast të trafikimit të hetuar nga prokurori publik në Prizren, një viktimë e mitur nga Shqipëria dha tri deklarata të njëjta mes 1 korrikut 2004 dhe 30 dhjetor 2004. Ajo ofroi dëshmi inkriminuese kundër të pandehurve duke treguar se ata e kishin trafikuar dhe dhunuar atë. Ajo gjithashtu tha se ata e kishin kërcënuar ta “vrisnin atë, vëllain e saj të vetëm dhe të gjithë familjen”, “ta zhdukin të gjithë familjen e saj të gjerë” dhe të ja “prenë kokën” në qoftë se ajo do t'i lajmëronte në polici. Përkundër kësaj, asnjë masë mbrojtëse nuk iu kishte ofruar asaj. Kur ajo dëshmoi në gjykim me 23 maj 2005 ishte e shoqëruar nga prindërit dhe dajën e njërit nga të pandehurit. Ajo ndryshoi deklaratën në masë të gjerë duke i tërhequr të gjitha dëshmitë inkriminuese të cilat i kishte dhënë më herët. Si shënim pozitiv, si Gjykata e Qarkut në Prizren më 20 Korrik 2005, ashtu edhe Gjykata Supreme e Kosovës më 28 Maj 2007 e karakterizuan versionin e saj të ri të ngjarjeve si “qesharak.”

Në një rast tjetër të trafikimit, më 27 qershor 2007 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Priştina gjatë një mundësie të jashtëzakonshme hetimore u dëgjuan dëshmitë e dy viktimave. Ngaqë seanca u mbajt në një zyrë tejet të vogël viktimat ishin të detyruara të ulen pranë të pandehurit. I pandehuri ndërhynte gjatë tërë kohës që ato jepnin deklaratat e tyre. Gjyqtari i procedurës paraprake vetëm në një rast ia tërhoqi vërejtjen të pandehurit që të mos ndërhynte mirëpo nuk e largoi nga zyra e gjykatës. Në këtë seancë të dy viktimat i ndryshuan deklaratat e tyre krejtësisht dhe versionin e ri që e dhanë ishte në kundërtënie me faktet.

Është e mundshme që të ketë pasur kërcënim ose frikësim nga ana e të pandehurit në rastet kur viktimat rrënjësisht i ndërrojnë deklaratat e tyre, ose refuzojnë të dëshmojnë kundër të dyshuarve ose kur janë të përmbajtura. Në raste të tilla, policia, prokurorët dhe

¹¹⁰ Frikësimi dhe mbrojtja e dëshmitarëve është temë e cila do të trajtohet në një raport të ardhshëm që do jetë projekt i përbashkët i OSBE-së me Departamentin e Drejtësisë të SHBA-ve të quajtur Siguria dhe mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë: *Vlerësimi dhe Rekomandimet* (pritet në nëntor të vitit 2007). Kjo temë tashmë është trajtuar në raportet e mëhershme të OSBE-së. Shih raportet e hartuara nga Misioni i OSBE-së në Kosovë me titujt që vijojnë Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale, Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, Administrimi i drejtësisë në gjykatat për kundërvajtje, Të miturit në procedurën penale (dhjetor 2006, fq. 8-18); Reagimi i sistemit juridik ndaj trazirave të marsit 2004 (2 dhjetor 2005 fq. 8-21); Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale: krimi, paraburgimi dhe dënimi (14 dhjetor 2004, fq. 74-77); Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale: Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale (20 maj 2003).

¹¹¹ Neni 139, KPPK, në lidhje me nenin 20 KPPK, tentim trafikimin e përcakton si vepër të dënueshme.

gjyqtarët kanë për detyrë t'i sigurojnë viktimës/dëshmitarit mbrojtjen më të lartë të mundshme. Dështimi për të vepruar në këtë mënyrë jo vetëm që e rrezikon sigurinë e viktimës ose të dëshmitarit mirëpo në të njëjtën kohë e zvogëlon mundësinë për të siguruar dëshmi fajësuese kundër trafikantëve.

Shembujt e mëposhtëm nxjerrin edhe më tepër në pah atë që autoritetet kosovare dështojnë në mbrojtjen adekuate të viktimave të trafikimit të cilat rrezikojnë dukshëm kur dëshmojnë kundër atyre që i shfrytëzojnë.

Në shqyrtimin kryesor të datës 27 qershor 2005, në një lëndë trafikimi pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, viktimë e njoftoi trupin gjykues që kishte pranuar thirrje kërcënuese telefonike. Gjegjësisht me një porosi e kishin paralajmëruar që në rast se të pandehurit do shpallehin fajtor atë do ta “gjenin telashe të mëdha.” Kryetari i trupit gjykues i kishte shpërfillur ato kërcënime dhe nuk kishte dhënë urdhër për zbatim të ndonjëres nga masat për mbrojtje.

Në një rast të trafikimit të supozuar të hetuar nga prokurori i qarkut në Prizren, më 31 janar 2007 një grua nga Shqipëria e kishte lajmëruar policinë që kishte qenë e detyruar të merrej me prostitucion nga ana e dy individëve, të cilët u arrestuan pas pak kohe. Policisë ajo i shfaqti shenja të dukshme të keqtrajtimit fizik që i mbështetnin pretendimet e saj. Sidoqoftë, gjatë seancës hetimore të mbajtur më 2 shkurt 2007 para prokurorit të qarkut, gruaja ndryshoi tërësisht deklaratën e saj. Ajo kërkoi falje për thëniet e saj në polici të cilat i kishte deklaruar kinse në “gjendje shoku.”¹¹² Gjatë dhënies së dëshmisë pala e dëmtuar dukej se shikonte në drejtim të avokatit mbrojtës në kërkim të pëlqimit për deklaratën e saj.¹¹³ Prokurori nuk parashittoi kërkesë dhe gjykata nuk dha urdhër për zbatim të masave për mbrojtjen e dëshmitarit.

Në një rast të supozuar të trafikimit para autoriteteve në Prishtinë/Priština, më 6 tetor 2006 policia bëri arrestimin e disa femrave nga Moldavia të cilat i vendosi në strehimore. Përkundër dyshimit që së paku njëra nga ato të ketë qenë e përfshirë në trafikim atë nuk e ndanë nga viktimat e mundshme.¹¹⁴ Për më tepër, nuk ishte bërë asnjë kërkesë ose nuk ishte lëshuar asnjë urdhër për zbatimin e masave për mbrojtje të viktimave të supozuara.

Shpeshherë është vështirë të dëshmohet frikësimi i dëshmitarëve ngase ka dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në ndryshimin e deklaratave. Sidoqoftë, madje edhe në disa nga rastet e monitoruara, OSBE-ja ka vërejtur dëshmi të drejtpërdrejta të kërcënimit ndaj dëshmitarëve. Ndonëse është alarmante që dëshmitarët dhe/ose viktimat kërcënohen, frikësohen dhe i nënshtrohen presionit në familje, më shqetësues është fakti që prokurorët

¹¹² Gjatë qëndrimit të saj në stacionin policor ajo tha që kishte qenë e dhunuar, e detyruar të merret me prostitucion dhe e lënduar me thikë në krahë. Para prokurorit ajo tha që tre trafikantët e supozuar nuk i kishin sjellë asnjë të keqe dhe se plaga, e prerë me thikë, në krahë e saj i ishte shkaktuar nga njëri nga trafikantët i cili “vetëm kishte lozur.”

¹¹³ Vini re që në bazë të kërkesës së saj dhe të prokurorit, viktimë e supozuar ishte kthyer në atdheun e saj.

¹¹⁴ Vini re që viktimë e supozuar më pas kishte refuzuar të bashkëpunoj me prokurorin.

dështojnë të bëjnë kërkesë ndërsa gjyqtarët dështojnë të lëshojnë urdhër për zbatimin e masave themelore për mbrojtjen e dëshmitarëve. Kjo cenon ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, vë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e viktimave dhe të dëshmitarëve dhe i pengon prokurorët që t'i sjellin trafikantët para drejtësisë.

Përfundimisht, nënkuptohet se viktimat dhe dëshmitarët ngurrojnë të dëshmojnë për kërcënimet ose kundër trafikantëve. Andaj, duke lënë anash kërkesat për masat për mbrojtje, autoritetet e hetuesisë duhet të zhvillojnë teknika pro-aktive të hetimeve me qëllim të zvogëlimit të vartësisë në dëshmitë e viktimave.¹¹⁵ Masat e tilla, të zbatuara në një përqindje të ulët të rasteve të monitoruara të trafikimit mund të përfshijnë hetimet e fshehta,¹¹⁶ përgjimin e telefonatave, monitorimin e fshehtë të bisedave, monitorimin e postës elektronike dhe internetit (që lejohet me ligjin në fuqi të Kosovës), ose vëzhgimin e fshehtë fotografik ose me video.¹¹⁷

PËRFUNDIMI

OSBE-ja ka raportuar mbi çështjen e trafikimit në pesë raste të tjera para këtij raporti. Rrjedhimisht, është shqetësuese të shënohet se problemet e identifikuara asokohe vazhdojnë së ekzistuari edhe sot në Kosovë. Policia, prokurorët, gjyqtarët, mbrojtësit e viktimave dhe ligjvënësit, thjeshtë dështuan t'i adresojnë në mënyrë adekuate problemet në rastet e trafikimit.

Në raportet e mëparshme (nga viti 2001 deri në vitin 2004) OSBE-ja ka vërejtur këto çështje shqetësuese në lëndët e trafikimit:

- Kërcënimi dhe mungesa e masave për mbrojtje të viktimave dhe të dëshmitarëve (tri herë);¹¹⁸
- Hetimi joadekuat në rastet e lidhura me trafikim (dy herë);¹¹⁹
- Mungesa e përkthimit adekuat (dy herë);¹²⁰
- Interpretimi i gabuar i veprës penale të trafikimit (dy herë);¹²¹
- Dështimi në sigurimin e dëshmisë së viktimës në gjykatë;¹²²

¹¹⁵ Shih Parimet e rekomanduara të UNHCR-it, Direktiva nr. 5, pika 3.

¹¹⁶ Është pozitive të përmendet që OSBE-ja ka monitoruar raste kur zyrat e prokurorisë në Prishtinë/Priştina dhe Prizren me sukses kanë bërë zbatimin e masave të fshehta të hetuesisë. Këto dy prokurori (në vitin 2006 dhe 2007) kanë ndjekur penalisht dhe kanë dënuar (pesë gjegjësisht tri) në numër më të lartë të rasteve të trafikimit në krahasim me rajonet tjera. Gjykatat në Mitrovicë/Mitrovica dhe në Gjiilan/Gnjilane nxorren dënime në nga një rast të trafikimit dhe në Pejë asnjë gjykatë nuk dënoi asnjë rast të trafikimit brenda kësaj periudhe kohore.

¹¹⁷ Shih nenin 256 ff., KPPPK.

¹¹⁸ Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale, (tetor 2001), Shqyrtimi i katërt i sistemit të drejtësisë penale (shkurt 2002), dhe Shqyrtimi i pestë i sistemit të drejtësisë penale, (prill 2003).

¹¹⁹ Shqyrtimi i parë i sistemit të drejtësisë penale, nga SMSL-ja (korrik 2000), dhe Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale (tetor 2001).

¹²⁰ Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale (tetor 2001) dhe Shqyrtimi i pestë i sistemit të drejtësisë penale (prill 2003).

¹²¹ Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale, nga (tetor 2001) dhe Shqyrtimi i katërt i sistemit të drejtësisë penale (shkurt 2002).

- Roli pasiv i mbrojtësve të viktimave;¹²³
- Dënimi i ulët i trafikantëve;¹²⁴
- Arrestimi i viktimave të trafikimit në vend të trafikantëve;¹²⁵
- Përfshirja e mundshme e oficerëve të policisë në aktivitete të trafikimit;¹²⁶
- Nevoja për shpërndarjen e Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 nëpër gjykata.¹²⁷

Të gjitha çështjet e numëruara më lart (përpos nevojës për shpërndarjen e Rregullores së UNMIK-ut 2001/4) janë përmendur edhe në raportin e tanishëm dhe janë vërejtur nga OSBE-ja gjatë monitorimit të rasteve të trafikimit në Kosovë.

Ndoshta kërcënimi i vazhdueshëm i dëshmitarëve dhe i viktimave është problemi më alarmant dhe urgjent që duhet adresuar. Para se të hynte në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/20¹²⁸ dhe KPPPK-ja, prokurorët dhe gjyqtarët deklarorin që u mungonin instrumentet ligjore për mbrojtjen adekuate të dëshmitarëve/viktimave. Ekziston nevojë urgjente për miratimin e një programi për zhvendosjen e dëshmitarëve që posedon fonde adekuate, si dhe zhvillimi i lidhjeve me vendet tjera të cilat do i pranonin dëshmitarët e mbrojtur. Sidoqoftë, është veçanërisht shqetësues fakti që në rastet më të fundit të trafikimit, përkundër se të gjitha masat për mbrojtje janë në dispozicion, viktimave u jepet fare pak mbrojtje për të mos thënë aspak.

¹²² Shqyrtimi i parë i sistemit të drejtësisë penale, (korrik 2000).

¹²³ Shqyrtimi i parë i sistemit të drejtësisë penale, (korrik 2000).

¹²⁴ Shqyrtimi i gjashtë i sistemit të drejtësisë penale, (tetor 2004).

¹²⁵ Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale, (tetor 2001).

¹²⁶ Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale, (tetor 2001).

¹²⁷ Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale, (tetor 2001).

¹²⁸ Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/20 dhe Udhëzimin administrativ nr. 2002/25.

REKOMANDIMET

Për ligjvënësin:

- Të nxjerrë një ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve duke themeluar një program formal për zhvendosjen e dëshmitarëve që lejon përfshirjen e viktimave të trafikimit dhe të dëshmitarëve.
- Të ndryshoj nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 në mënyrë që viktima të mos ketë nevojë të dëshmoj se ajo është viktimë e trafikimit për t'i ikur ndjekjes penale për prostitucion, kalim ilegal kufiri ose qëndrim të paligjshëm.
- Pasiqë prostitucioni është joligjor në Kosovë, të njerrë një ligj sipas të cilit pranimi i shërbimeve seksuale nga një prostitutë paraqet vepër penale.

Për Gjykatën Supreme të Kosovës:

- Të nxjerrë vendim me udhëzime të qarta për gjykatat më të ulëta në Kosovë duke interpretuar nenin 139 të KPPK-së dhe llojet e gjendjeve faktike që formojnë ose nuk formojnë elementet e veprës penale të trafikimit.

Për gjyqtarët e Kosovës:

- Të shpallë fajësi vetëm në ato raste të trafikimit ku prokuroria siguron dëshmi të mjaftueshme që i formojnë të gjitha elementet e domosdoshme të nenit 139 të KPPK-së.
- Në rastet e trafikimit të lëshojnë urdhër për zbatimin e masave për mbrojtje të parapara në KPPK-në, sikurse janë ndarja fizike e viktimës dhe dëshmitarëve nga të pandehurit, përdorimi i ndryshimit të fotografisë ose zërit, dhe dëshmia e dhënë nga larg.
- Të sigurojnë që të gjitha viktimat e trafikimit të jenë të përfaqësuara nga mbrojtësi ose/dhe përfaqësuesi i autorizuar.
- Në pajtim me nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4, të hedhin poshtë akuzat kundër viktimave të trafikimit për veprën penale të kalimit ilegal të kufirit ose të kundërvajtjes për prostitucion ose qëndrim të paligjshëm.

Për prokurorët e Kosovës:

- Të mos i ndjekin penalisht të pandehurit për trafikim në rastet kur elementet e domosdoshme nën nenin 139 të KPPK-së nuk mund të vërtetohen. Nëse faktet nuk e mbështesin rastin e trafikimit shqyrtoni mundësinë për t'i ngarkuar me vepra penale më të ulëta sikurse është mundësia e prostitucionit ose kontrabandimi me migrantë.
- Të zhvillojnë hetime të plota në rastet e trafikimit që nuk mbështeten vetëm në dëshminë e viktimës. Përdorni më shpesh hetimet e fshehta, përgjimin, monitorimin e fshehtë të bisedave, fotografimin e fshehtë ose video-vëzhgimin, ose përgjimin e komunikimeve nëpërmes të rrejtë kompjuterik.
- Të ndiqen penalisht të gjithë personat (përfshirë përdoruesit e shërbimeve seksuale nën nenin 139 (5) të KPPK-së) të cilët kanë kryer vepra penale në kontekst të veprës së trafikimit.
- Të trajtohen viktimat e trafikimit si të tilla – pa marrë parasysh nëse ato bashkëpunojnë/japin informata apo jo.

- Të merren në pyetje viktimat në mënyrë të ndjeshme duke mos cenuar dinjitetin e tyre.
- Të kërkohet mbrojtje për viktimat e trafikimit dhe dëshmitarët nga gjykata dhe çdo subjekt i ardhshëm i përfshirë në mbrojtjen e dëshmitarëve (sikurse është komiteti për mbrojtjen e viktimave i cili vendos mbi kërkesat për përfshirje në programin për zhvendosje).

Për Shërbimin Policor të Kosovës (në veçanti për Sektorin e trafikimit me njerëz):

- Të hetohen me kujdes nëse një person mund të jetë viktimë e trafikimit.
- Në rastin e parë të mundshëm të njoftohen viktimat e trafikimit për të drejtat e tyre në procedurën penale të parapara me KPPK-në dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/4.
- Të sigurohet mbrojtje për personat për të cilët ekziston dyshim i arsyeshëm se mund të jenë ose të kenë qenë viktimat e trafikimit.
- Të mos i mohojnë ndihmën një viktime të mundshme të trafikimit ngase ai ose ajo refuzon të bashkëpunojë ose të jep informata.
- T'i shmangen arrestimeve ose fillimit të procedurës për kundërvajtje për prostitucion ose qëndrim të paligjshëm kundër personave që mund të jenë viktimat e trafikimit (pa marrë parasysh nëse bashkëpunojnë apo jo).

Për Odën e Avokatëve:

- Të udhëzohen avokatët të ushtrojnë ankesë kundër vendimeve të trafikimit në të cilat nuk janë të vërtetuara elementet e kërkuara nën nenin 139 të KPPK-së.
- Të udhëzohen avokatët që i përfaqësojnë viktimat e trafikimit t'u ndihmojnë në mënyrë pro-aktive.
- Të udhëzohen avokatët t'i kundërshtojnë ose të përmbahen nga parashtrimi i pyetjeve, të cilat mund të cenojnë dinjitetin e viktimave të trafikimit.

Për Njësitin për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave:


- Të ndihmohen viktimat e trafikimit në mënyrë pro-aktive përgjatë procedurës penale dhe informoni ato/ata për të drejtat e tyre.
- Të kundërshtojnë rastet e intervistimeve të papërshtatshme dhe/ose jo diskrete të viktimave të trafikimit.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:

- Të trajnohen gjyqtarët dhe prokurorët në lidhje me kërkesat nga neni 139 i KPPK-së, metodat për mbrojtjen e dëshmitarëve, që i kanë në dispozicion si dhe për teknikat e hetimeve të fshehta (sikurse është përgjimi ose/dhe hetimet e fshehta).

ANEKS

Rastet e trafikimit në Kosovë prej vitit 2006 deri më sot



* Bazuar në informatat e sigurara për OSBE-në, nga punëtorët e gjykatave të Kosovës